



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më 18.11.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi, në parim, i shpenzimeve të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2020.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Ervin Bushati, Arben Elezi, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ylli Shehu, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Anastas Angjeli, Suzana Topi

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Korab Lita,

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Anila Denaj, Ministre

Znj. Mimoza Dhembli, Drejtoresh e përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

Znj. Suzana Stefa, Drejtoresh,

Z. Fran Brahimi, Drejtor

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – ...shpenzimet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2020. Unë nuk po veproj si zakonisht që relatori të mbajë qëndrim; do të mbajmë qëndrim, pasi ministrja të ketë bërë prezantimin e saj për shpenzimet. Ndërkohë, në mos gabohem, ne kemi planifikuar një mbledhje të veçantë për investimet publike. Është kështu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Ndërkohë, dua dy dëgjesa, një me katër-pesë kryetarë bashkie: i Tiranës, i Durrësit, i Fierit, i Vlorës, i Korçës dhe Elbasanit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkodra nuk ka kryetar bashkie. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është Vlora, është qendra e qarkut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është Komisioni i Ekonomisë dhe këtu vihet me ftesë. Këtu edhe media vjen me ftesë, lëre më pastaj kryetarët!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni? Kë keni ju, për shembull? Prandaj jeni ju deputet, që mbulonit Selenicën, që ta prezantoni problematikën e Selenicës, ndërkohë unë jam deputet i qarkut të Tiranës, ndaj përfaqësuesit e Kavajës dhe të Rrogozhinës nuk do të vijnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse do të vijnë zoti Erion Veliaj dhe zonja Valbona Sako për qarkun e Durrësit, do të vijë Raqi i Korçës, do të vijë Tan Leli i Vlorës, do të vijë edhe ky djali i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Armando Subashi; do të vijë edhe Gledi. Ndërsa nga Shkodra nuk kemi kryetar. Nuk e di si do t'ia bëjmë me Shkodrën, por, gjithsesi, do ta diskutojmë.

Anastas Angjeli – Do të vijnë zëvendësit.

Arben Ahmetaj – Dakord. Atëherë, fillojmë me prezantimin nga ministrja Denaj, për të vijuar më tutje me pyetje.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Anila Denaj – Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Të nderuar deputetë,

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose 29,7% të produktit të brendshëm bruto. Ato rriten me 5,1%, krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Shpenzimet e personelit janë të programuara në masën 83,5 miliardë lekë për vitin 2020, ku, përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike qendrore, faktorizojnë gjithashtu edhe efektet e plota të politikës së rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë, të arsimit, të mbrojtjes, të sistemit penitenciar dhe të punonjësve të përfaqësive diplomatike, të cilat patën rritje prej 1 prillit të këtij viti. Dua të theksoj këtu edhe efektet e konsiderueshme financiare që ka edhe në buxhetin e këtij viti, njëkohësisht të vitit 2020, reforma në drejtësi, e cila merr në konsideratë jo vetëm rritjen e 2,6 miliardë lekëve të këtij viti, por edhe 1,1 miliardë lekë shtesë për vitin që vjen.

Në total, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përllëgarit që për vitin 2020 efektet shtesë në zërin “Shpenzime personeli”, që i atribuohen kësaj reforme shumë të rëndësishme, kapin vlerën 3,5 miliardë lekë.

Ka pasur relativisht pyetje dhe shqetësime nga shumë prej të interesuarve gjatë shqyrtimeve, nëse do të ketë politikë rritjeje të pagave në administratën publike. Më lejoni t’ju them që, sigurisht, politika e pagave nuk mund të konsiderohet vit pas viti. Ajo është një politikë, sikurse çdo politikë tjetër, që duhet të shkojë në nivelin afatmesëm dhe, si e tillë, duhet të ketë shumë kujdes në planifikim, pasi edhe efektet financiare janë të tilla që krijojnë jo vetëm kosto shtesë, por, përpara se kjo të ndodhë, ne duhet të bëjmë një analizë shumë të mirë të të gjithë sistemit.

Rritja e pagave prodhon efekte gjatë gjithë kohës, duke ngushtuar hapësirën për politika të tjera, por, siç e thashë edhe më parë, ka nevojë për të bërë një analizë të mirëfilltë të të gjithë sistemit dhe harmonizim të kategorizimeve si në pushtetin vendor, ashtu edhe në pushtetin qendror. I njëjti shqetësim është adresuar edhe në këtë komision, edhe në komisionet e tjera, ku kemi marrë pjesë, kryesisht tek ai i Ligjeve, ku fokusi ka qenë te kategorizimi i pagave për sistemin vendor.

Kështu, duke i mirëpritur këto sugjerime, por edhe duke parë nevojën për të rritur eficientësin e administratës publike, konsiderojmë që politikat afatmesme të rritjeve të pagave do të shkojnë paralelisht edhe me një sistem të ristrukturuar, të harmonizuar dhe kundrejt të gjithë rritjes së aktivitetit të tij në afatmesëm. Nëse ky ushtrim ndodh në vitin 2020, sigurisht do të ketë hapësirë për të parë për kosto shtesë në vitin 2021 dhe vijimësisht.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes programohen në vlerën 50 miliardë lekë, me një rritje të kujdesshme prej 4,4% ndaj të pritshmit të vitit 2019. Fokusi vijon të mbetet mirëmbajtja e aseteve të vëna në efikasitet si rezultat i projekteve të investimeve të ndërmarra më parë kundrejt shpenzimeve operative. Konkretisht, mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor kombëtar zënë pjesën më të madhe për këtë zë.

Mirëmbajtja e rrjetit rrugor kombëtar do të ketë një mbështetje të konsiderueshme edhe për vitin 2020, ku, krahas shumës prej 1,6 miliardë lekësh, që parashikohet për vitin 2020 me financim të brendshëm, parashikohen rreth 1,8 miliardë lekë që do të financohen këtë vit nga projekti i mirëmbajtjes me Bankën Botërore, duke e çuar financimin në total me 3,4 miliardë lekë. Sfidë mbetet që, pas mbarimit të këtij projekti, të kemi minimalisht këtë nivel financimi për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale edhe në vijim, duke pasur parasysh që mirëmbajtjet janë një element tejet i rëndësishëm për të reduktuar kostot e panevojshme shtesë në vijim. Sigurisht, kjo kosto e mirëmbajtjes, edhe në projekt fizibiliteti, duhet të konsiderohet që në momentin e parë, sikurse duhet të konsiderohet e gjithë vlera e shpronësimeve, të cilat japin një analizë më të plotë edhe në nivelin e buxhetimit, edhe në nivelin e efektivitetit të çdo investimi.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 40,9 miliardë lekë ose 2,3% të prodhimit të brendshëm bruto. Këto përfshijnë kontingjenca të mjaftueshme për të përballuar, edhe nëse do të kishte një rritje të normave të interesit. Këto kontingjenca, të përlogaritura në 7,5% të totalit të shpenzimeve buxhetore, respektojnë rigorozisht edhe rregullin fiskal, i vendosur me objektin e ligjit organik të buxhetit, ku kërkohet të mbahet minimalisht niveli 7% i shpenzimeve buxhetore totale si kontingjencë për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet e kurseve të këmbimit ose normat e interesit me ndikim në nivelin e borxhit.

Për sa u takon subvencioneve, programohen rreth 1,3 miliardë lekë. Këtu është faktorizuar riallokimi i një pjese të mirë të subvencioneve të parashikuara për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve tek investimet publike për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve, në kuadër të përshpejtimit të reformës së ndërmarrë nga qeveria në këtë sektor.

Shpenzimet e fondeve të veçanta speciale, të cilat përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, si dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën 188,6 miliardë lekë. Konkretisht, ne kemi folur edhe për skemën e sigurimeve shoqërore dhe ato shëndetësore, por do t'i përmend shkurtimisht,

meqenëse flasim për shpenzimet. Në vitin 2020 niveli i shpenzimeve për skemë të sigurimeve shoqërore përlllogaritet në masën 137,5 miliardë lekë ose 7,7% të produktit të brendshëm bruto. Kjo skemë, sigurisht, ka pasur një zhvillim pozitiv, pasi kontributi është rritur edhe si rezultat i dy faktorëve.

Së pari, si rezultat i uljes së ndikimit që ka në tregun e punës pjesa e formalitetit.

Së dyti, si rezultat i rritjes së nivelit të punësimit dhe kontribuuesve.

Mbulimi i efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve (naftëtarë/minatorë), të cilat, pas rishikimit dhe të ligjit, do të kenë një efekt të harmonizuar prej 1,45 miliardë lekësh, janë marrë në konsideratë në buxhetin e vitit 2020: mbështetja me të ardhura mesatarisht nga 744, 792 mijë persona, që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare, si dhe një sërë të ardhurash të tjera të parashikuara me ligje dhe vendime të veçanta, si dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave; numri mesatar i kontribuuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet të jetë mbi 820 mijë persona, me një rritje në masën 4% nga i pritshmi në vitin 2019.

Për sa i takon skemës së sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2020 janë parashikuar rreth 44 miliardë lekë, ose 2,5% të produktit të brendshëm bruto, rreth 42 miliardë lekë më shumë sesa i pritshmi i vitit 2019.

Edhe këtë vit projektbuxheti parashikon një tavan prej 11 miliardë lekësh, si tavan për rimbursimin e barnave. Më lejoni të them se kjo është një shumë e rritur sipas ritmit të sëmundshmërisë vjetore dhe nga 10,5 miliardë, që ishte një vit më parë, konsiderohet 11 miliardë vitin e ardhshëm. Sigurisht, kjo bëhet për të mbajtur në kontroll shpenzimet për këta zëra. Më lejoni të them që në këtë aspekt Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bërë mjaftueshëm përparim për të negociuar çmimet e caktuara, duke realizuar kursime dhe duke paguar një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve të prapambetura.

Fondi për kompensim në vlerë të ish-pronarëve parashikohet në total rreth 4,5 miliardë lekë. Kuptohet, ky fond është rritur nga viti në vit. Ka filluar me 1,9 miliardë lekë në vitin 2013 dhe aktualisht jemi, siç e thashë, në vlerën 4,5 miliardë. Parashikohet që në vitin 2022 të shkojë në vlerën 5,5 miliardë lekë. Kjo edhe falë projeksionit që kemi në bazë të ligjit dhe të angazhimit të qeverisë shqiptare për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për ta realizuar brenda periudhës 2-vjeçare, të parashikuar në ligjin nr. 133/2015. Shpenzimet e tjera sociale janë programuar në masën 24,6 miliardë lekë. Konkretisht, pagesa e papunësisë është në nivelin 600 milionë lekë. Shpenzimet në këtë zë kanë ardhur në rënie prej vitit 2014, ku ishte shënuar niveli i 900 milionë lekëve, kjo falë

edhe politikave pro punësimit. Është e rëndësishme të themi që këto politika marrin fokus dhe vëmendje të veçantë, sepse kanë realizuar jo vetëm thjesht uljen e mbështetjes buxhetore, por, mbi të gjitha, kanë realizuar penetrimin në tregun e punës të një force aktive, e cila kalon nga mbështetja sociale në një mbështetje proaktive për punësim. Kësaj i ka shërbyer edhe ligji i punësimit, i miratuar në maj të këtij viti.

Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar janë në nivelin 21 miliardë lekë. Për rritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të këtyre skemave, që zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale buxhetore, po bashkëpunohet edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për t'i pastruar skemat nga përfituesit abuzivë, si dhe duke forcuar sistemet e vlerësimit të përfitueshmërisë nga këto skema. Gjithashtu, qeveria po punon për të nxitur punësimin e kategorive të personave me aftësi të kufizuar drejt tregut të punës, në mënyrë që të kemi një nxitje më të madhe të punësimit të vijim.

Për sa u përket ish-të përndjekurve, është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh, i cili do të synojë kryesisht shlyerjen e kësteve për trashëgimtarët e ish-të përndjekurve, pasi është realizuar edhe shpërblimi për pothuajse 95% të ish-të përndjekurve, të cilët janë gjallë.

Për sa i përket bonusit të lindjeve, sërish është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh, ku edhe këtë vit parashikohet të mbështeten dhe të përfitojnë rreth 30 000 familje nga ky fond.

Për sa i takon fondit rezervë, për vitin 2020 është parashikuar në nivelin 1,7 miliardë lekë, respektivisht i ndarë në 1,4 miliardë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 300 milionë lekë, që shkon si fond kontingjence për financimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Në raport me investimet publike, për vitin 2020 janë parashikuar në nivelin 4,7% të produktit të brendshëm bruto ose rreth 84 miliardë lekë. Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktore. Sigurisht, në disa nga këto investime kemi parë edhe nevojën për t'i shtyrë disa. Megjithatë, konkretisht, në infrastrukturën rrugore synohet kompletimi i akseve rrugore nacionale: Rruga e Arbrit në vitin 2021, sipas kontratës; segmentet Milot-Balldren dhe Orikum-Dukat, brenda vitit 2022; kompletimi i pjesës dërrmuese të segmenteve rrugore në vazhdim me financim të brendshëm, si Kardhiq-Delvinë, Elbasan-Banjë, bajpasi i Tepelenës, bajpasi i Shkodrës, si dhe një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës brenda vitit 2022. Një vend të rëndësishëm zënë edhe përfundimi i rrugëve ose i infrastrukturës rrugore me financim të huaj, si ai i bajpasit të Fierit, të Vlorës

dhe bajpasi Qukës-Qafë Plloçë. Në raport me dy të parat, parashikohet kompletimi brenda vitit 2021. Në raport me financimin e rrugës Qukës-Qafë Plloçë, jemi ende në bisedime për të parë mundësinë e nevojës së financimit të huaj, pasi konkretisht kërkohet një mbështetje më e lartë në këtë aspekt.

Në raport me arsimin, synohet dyfishi i investimeve për arsimin e lartë, të paktën nga 340 në 750 milionë lekë, i cili do të fokusohet në zgjerimin dhe në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për mësimdhënien dhe akomodimet, kryesisht konviktet e universiteteve publike. Edhe këtë vit, më lejoni ta theksoj, është alokuar një fond i konsiderueshëm për përmirësimin e kushteve të ambienteve mësimdhënëse dhe akomoduese. Megjithatë, ky është një plan afatmesëm dhe vitin që vjen, sigurisht, është vendosur në vijimësi në fokus të investimeve.

Për sa u takon investimeve kapitale në shëndetësi, synohet investimi i 120 qendrave shëndetësore, në një vlerë prej 350 milionë lekë.

Për sa i përket infrastrukturës rajonale dhe vendore, synohet përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat me potencial më të lartë të turizmit, avancimi i projekteve në kuadër të projektit “100 fshatrat”, ndërtimi dhe rehabilitimi i segmenteve rrugore që lidhin dhe afrojnë rajonet e fshatrave me akset nacionale, në mënyrë që edhe integrimi i infrastrukturës të bëhet i plotë.

Për sa i takon mbrojtjes, synohet përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës mbrojtëse në përputhje me standardet e NATO-s. Theksoj këtu, edhe një herë, që ky sektor përfiton fonde gjithnjë e më shumë në përputhje me angazhimet që ka qeveria shqiptare ndaj kësaj organizate për t’i çuar financimet në këtë sektor në 2% të produktit të brendshëm bruto në vitin 2024.

Së fundi, dëshiroj të prezantoj edhe kuadrin e shpenzimeve që parashikohet për njësitë e qeverisjes vendore. Pra, buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020 është programuar në rreth 57 miliardë lekë ose 11,2% më i lartë sesa ai i pritshmi i vitit 2019.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë që në këtë projektbuxhet ky raport i investimit, në raport me produktin e brendshëm bruto, është 3,2%. Rritja e burimeve të buxhetit vendor krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Siç e tha edhe kryetari, ju do të keni mundësi që me disa nga këto njësi të pushtetit vendor të bisedoni drejtpërdrejt. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të rritet edhe ndërgjegjësimi i pushtetit vendor në miradministrimin e fondeve, sikurse të rritet më tej edhe

potenciali për të administruar një rritje më të qenësishme të të ardhurave në nivelin afatmesëm, pasi jo të gjitha burimet janë vendosur në funksion të rritjes së të ardhurave.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2020, edhe një herë, do të jetë konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel qendror, në funksion edhe të vazhdimit të reformës administrativo-territoriale, të decentralizimit fiskal. Angazhimi ynë është që të rrisim ndërgjegjësimin e pushtetit vendor në raport me miradministrimin. Për këtë kemi krijuar edhe një platformë komunikimi për një analizë vetëvlerësimi dhe një guidë shoqëruese për ta rritur këtë analizë në nivelin e pushtetit vendor. Besojmë që në të ardhmen ky proces do të jetë shumë më mirë i integruar edhe me sistemet e rritjes së ndikimit të auditit dhe Komitetit të Auditit, që do të duhet të shikohet në nivel qarku sipas iniciativave të ndërmarra edhe nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor, që është Ministria e Brendshme.

Në vitin 2020, më lejoni të theksoj që ka një element të rëndësishëm që nuk e kemi thënë herët e shkuara që, kur vjen çështja te sistemi parashkollor, për sa kohë ka një ndryshim metodologjie në numrin dhe në shpërndarjen e mësuesve ndaj nxënësve, ku elemente bazë të kësaj metodologjie nuk janë më numri i mësuesve ose i edukatorëve, por është numri i fëmijëve, kuptohet që do të ketë një numër të shtuar edukatorësh. Do të jenë 440 edukatorë më shumë sesa në vitin 2019, që janë shpërndarë në 32 bashki, të cilat kanë një nevojë më të madhe për shtimin e shërbimit në këtë aspekt. Kështu që besojmë se do të ketë një ndikim edhe më të madh edhe në rritjen e cilësisë së nivelit të arsimit parashkollor në nivel lokal.

Mbetemi të hapur për pyetje dhe diskutime. Prezentë kam edhe kolegët e mi si nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, si për aspektin e investimeve, ashtu edhe të pushtetit vendor.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Ka pyetje? Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Ndërkohë, zoti kryetar, më lejoni t'i shoqëroj edhe me ndonjë koment të vogël që të mos më komente në fund dhe pyetje.

Arben Ahmetaj – Po, patjetër.

Artur Roshi – Në përgjithësi, teoritë ekonomike janë studim i zgjedhjeve. Mirëpo ato nuk na thonë se çfarë zgjedhim, por thjesht na ndihmojnë të kuptojmë gabimet se si kemi zgjedhur. Në këtë kontekst, shoh që qeveria (se këtë i shohim qeverisë, se cilat janë gabimet që ajo ka bërë deri sot për buxhetet e vitit që po lëmë pas) është e dhënë kryesisht ndërmjet buxheteve të balancuara dhe për këtë mundohet me çdo kusht, pothuajse në mënyrë teorike,

të ruajë parametrat ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave. Por, në fakt, që të ruash buxhete të balancuara, normalisht duhet ose t'i ulësh shpenzimet, ose të rrisësh taksat. Ju zgjidhni kryesisht këtë të dytën.

Unë them që rëniet ekonomike duhet të shoqërohen kryesisht me tolerimin e deficiteve buxhetore. Ju nuk e pranoni këtë dhe mundoheni ta kontrolloni. Ky është ndryshimi mes nesh. Ndaj pyetjet e mia janë: cila është arsyeja e uljes së shpenzimeve kapitale, pra e investimeve me financim të brendshëm, si dhe atyre me financim të huaj, të cilat kanë shënuar rënie këtë vit? A do ta ndjekë kjo rënie vitin që vjen këtë zë në preventivin e buxhetit? Pra, kanë rënie të dyja, edhe financimi i brendshëm, edhe financimi i huaj. A do ta ndjekë vitin që vjen kjo rënie?

Unë mendoj se jemi në një fazë, ku oportunitetet e investimeve kanë ikur, në fakt, na kanë lënë dhe ku konsumatorët kanë vendosur të ulin shpenzimet. Madje, ndonjë konsumator, që ka ndonjë kredi, është munduar t'i likuideojë ato kredi që ka marrë dhe prandaj në tërësi ne kemi një trend të uljeve të kredive të këqija. Kjo është arsyeja. Prandaj mendoj se qeveria në këtë situatë duhet të përgjigjet me politika çlirimi, jo me politika shtrënguese. Cilat janë politikat shtrënguese që reflektojnë te paketa fiskale që e shoqëron këtë projektbuxhet? Janë telashe të shtuara futja e deklarimit të 2 milionëshit në vit për njerëzit që punojnë në dy vende pune njëherësh, edhe taksa e regjistrimit të makinave, që e shoqëron sërish paketën fiskale, disa taksa luksi dhe disa taksa të tjera që e shoqërojnë këtë paketë. Ju lutem, përgjigjuni një herë pyetjes së parë, pastaj do të bëj edhe një pyetje tjetër.

Anila Denaj - Nuk e di ku u referoheni ju shifrave që ka ulje, pasi unë në relacionin tim u përmbahem zërave, në raport me të pritshmin 2019. Po flasim në total, në raport me të pritshmin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Patjetër, kur t'ju vijë radha, zonjë. Ju lutem, të mbarojë zoti Roshi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me qetësi, ju lutem, të mos i ndërhyjmë ministres, mëni të flasë dhe, kur të vijë radha juaj, mund ta rimerrni përsëri fjalën për pyetje.

Urdhëroni, zonja Ministre!

Anila Denaj – Po lexoj tabelën fiskale. Shpenzimet kapitale: i pritshmi i vitit 2019, 80,7% dhe buxheti i parashikuar 83,7%. Në këtë aspekt, nëse diferenca që i bëhet referencës, zoti Roshi, ka të bëjë me parashikimin, sigurisht që është e saktë, por ne flasim për një raport

me të pritshmin, pasi e kemi analizuar edhe kur folëm për të ardhurat që i pritshmi 2019 fillon me një bazë të ardhurash më të ulëta dhe, sigurisht, edhe investime më të ulëta. Sigurisht, këtë vit janë marrë masa që të mos cenohet asnjë nga parametrat fiskalë.

Në raport me çështjen e taksimit, unë në asnjë nga propozime që kemi bërë për ndryshime juridike në paketën fiskale, që nuk është subjekt i diskutimit të sotëm, por po jap përgjigje, nuk ka rritje taksash. Ne përsëri kemi bërë një incentiv për një **industri automotivësh** me 5%. A mund të jeni pak më konkret se ku konsiston rritja e taksave që ju u referoheni?

Për sa i takon deklarimit për të dypunësuarit, sigurisht, është një përmirësim procedural, i cili adreson 30 mijë të dypunësuarit. Pra, nuk po flasim për një numër të vogël, por për 30 mijë të dypunësuar dhe jo për kategori si ato të referuara në medie së fundi, por për profesione të nderuara të të gjitha niveleve, duke filluar nga niveli më i ulët i shërbimit te niveli më i lartë i shërbimit. Ato kanë nevojë të rregullohen për të qenë një taksim më i drejtë. Kjo nuk do të thotë se ne nuk po punojmë për një procedurë më të thjeshtuar për të adresuar kompleksitetin e deklarimit *online*. Deri në momentin e aplikimit të saj besoj se administrata tatimore është e angazhuar që të sjellë një format më të thjeshtuar të plotësimit, por principi që dypunësimi të shkojë drejt një standardi tjetër të qasjes, si në deklarim, ashtu edhe në taksim është i drejtë. Shpesh është vënë re se ka qenë edhe një burim i incentivuar si rezultat i hapësirës që lë ndarja dhe mostaksimi i drejtë. Kjo nuk do të thotë që vitin tjetër në diskutimin e paketës fiskale të mos shikojmë edhe grupe të tjera, të cilat kanë krijuar gjatë viteve nevojën për të kaluar nga një burim i vetëm rroge në burime të tjera të ardhurash, por ato më pas mund të konsiderohen taksime shtesë. Ato do t'i diskutojmë vitin tjetër. Ky është një ndryshim procedural dhe, sigurisht, do ta thjeshtojmë procedurën për ta adresuar lehtë për të gjithë të dypunësuarit.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje tjetër?

Urdhëroni, zoti Roshi!

Artur Roshi - Si i keni parë ju shpenzimet? Nga cili këndvështrim i keni parë prodhimet bujqësore, të cilat, sipas meje, krijojnë realisht pasuri. Pra, nuk është tregtia ajo që krijon pasuri, por janë investimet ose shpenzimet që bëhen në sektorin e bujqësisë, sipas meje. Cili është këndvështrimi juaj?

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Ministre!

Anila Denaj – Duke filluar nga ky vit, ne jemi angazhuar me një rritje. Aktualisht, po flasim për një skemë kompensimi subvencioni, e cila u shtua gjysmën e parë të vitit dhe,

sigurisht, do të vazhdojë impaktin e saj edhe vitin që vjen. Kjo shtesë duhet për t'u përmendur që këtë vit, sikurse edhe zërat e tjerë të investimeve. Në total bujqësia merr 1,8 miliardë lekë më shumë dhe është një nga 4 ministritë, të cilat kanë rritje të konsiderueshme. Konkretisht, zë më zë, në raport me investimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të shkojmë me programin, zë më zë, në qoftë se është e nevojshme.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Në kontekstin e taksave, qeveria kujdeset shumë edhe për taksën e dhuratave. Domethënë, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë për taksën e trashëgimisë, por për taksën që vendoset kur babai ia dhuron të birit. Në këtë moment ka taksë të transkriptimit të pronës nga i ati tek i biri. Pse nuk është taksë kjo? Si e quani ju këtë?

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, ti del shpesh, por nen për nen mund ta pyesësh ministren. Megjithatë, zonja Ministre, mund t'i përgjigjeni pyetjes së zotit Roshi për taksën e trashëgimisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk hyn te shpenzimet, por hyn te shpenzimet e zotit Roshi kur të marrë trashëgimi nga gjyshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të përgjigjet një herë ministrja, apo do të bëjmë pyetje dhe të mos përgjigjet ministrja fare?

Ju lutem, zonja Ministre, për taksën e trashëgimisë.

Anila Denaj – Nuk ka asnjë ndryshim në atë drejtim dhe besoj se kjo do të ishte pjesë e paketës, në qoftë se do të ishte sjellë. Nuk mendoj se ka nevojë për ndryshime kjo paketë.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Suzana!

Suzana Topi - Faleminderit, zonja Ministre!

Shpenzimet në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor janë parashikuar 44,1 miliardë lekë, nga 42 miliardë që ishin në vitin 2019. Dua të fokusohemi te ky zë, nisur nga nevojat e të sëmurëve me sëmundje kronikë për rimbursimin e barnave cilësore, të domosdoshme dhe jetike për të sëmurët me diabet për rimbursimin e fishave të diabetit. A do të ketë politika të reja në lidhje me këto rimbursime? Shpenzimet e tjera sociale për pagesën e ndihmës ekonomike, edhe për personat me aftësi të kufizuar kapin shifrën 21 miliardë lekë, si dhe 600 milionë janë shpenzime për pagesat e të papunëve. Kjo është shtresa më në nevojë

e popullatës. Një person me aftësi të kufizuar, që merr 10 500 lekë i takon në ditë 350 lekë, a do të ketë ndryshim në rritjen e këtyre të ardhurave për këtë kontigjent të popullatës?

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes së qeverisjes qendrore janë parashikuar 46,7 miliardë lekë. Në këtë zë është programuar një mbështetje me prioritet e politikave të qeverisjes qendrore në skemën e fermerëve. A është parashikuar nga qeveria subvencion për fermerët për prodhimet e tyre, si dhe a është parashikuar vlerësimi dhe kompensimi financiar me çmimin dysHEME të tregut për produktet e humbura nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nga stoku i prodhimit të shkaktuar nga çrregullimi i tregut?

Faleminderit!

Anila Denaj – Në raport me skemën e rimbursimit të medikamenteve, unë e përmenda pak më parë që në kontekstin e menaxhimit më efektiv të këtyre fondeve është vendosur që ne vitin e kaluar një tavan, i cili këtë vit, duke marrë parasysh sëmundshmërinë, është rritur në vlerë absolute nga 10,5 në 11 miliardë lekë. Se çfarë do të adresojë konkretisht lista e barnave të rimbursueshme është ministria e përgjegjshme që e adreson këtë çështje. Afati kohor për të filluar këtë proces besoj se ka nisur në fund të tetorit. Rritja e numrit prej 1 mijë të sëmurësh çdo vit me rimbursim është një kontekst i rëndësishëm për t'u përmendur. Se kush do të jetë konkretisht aty, besoj se i takon Ministrisë së Shëndetësisë për ta adresuar si çështje.

Nuk e di nëse Ministria e Shëndetësisë do të jetë këtu, por ne mund ta adresojmë dhe ajo ta sjellë.

Arben Ahmetaj – Jo, ministria e Shëndetësisë nuk do të jetë, por, në eksperiencën time, është detyra dhe përgjegjësia juaj, sepse, praktikisht, në atë aspekt, pavarësisht se fondi menaxhohet nga një institucion nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, është një fond i subvencionuar nga buxheti i shtetit dhe është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e ministrit të Financave (edhe për t'i ditur) që të përgjigjet për mbarrëvajtjen e fondit jo vetëm në total, por edhe në kategori.

Anila Denaj – Sigurisht, mund ta adresojmë.

Arben Ahmetaj – A mund të bëjë një pyetje, nëse më lejon zonja Suzana?

Së pari, nëse të kuptova drejt, më korrigjoni, fondi për rimbursimet, a ka kategori barnash të reja? A ka rears?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ishin këto pyetjet? Nuk ka gjë, po i bëj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Suzana, bëjeni pyetjen përsëri që ministrja t'i përgjigjet.

Suzana Topi – Për sigurimin e kujdesit të shëndetit janë parashikuar 44,1 miliardë lekë, nga 42 miliardë që ishin në vitin 2019, që është një rritje relativisht e vogël, jo shumë e madhe. Dua të fokusohemi te ky zë, nisur nga nevojat e të sëmurëve me sëmundje kronikë për rimbursimin e barnave cilësore, të domosdoshme dhe jetike. Për këtë kategori të sëmurësh a ka një politikë të re rimbursimesh për barnat në tërësi dhe a ka borxhe të prapambetura?

Anila Denaj – Nëse është përgjegjësi e Ministrisë së Financave ndjekja e të gjitha kategorive, sigurisht që do të kthehemi dhe do ta shikojmë nëse të sëmurët kronikë do të kenë në zërin e barnave të rimbursueshme një zë shtesë. Megjithatë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë konsideron se rritja e nivelit të tavanit nga 10,5 në 11 është një rritje, e cila ndjek ritmin e sëmundshmërisë. Lista e barnave të rimbursueshme, e cila këtë vit është publike, e adreson më së miri pyetjen tuaj. Nëse lista e barnave të reja do ta adresojë këtë kërkesë, lista e barnave të reja fillon punën tani dhe këtë nuk mund ta dijë Ministria e Financave.

Në raport me pyetjet që bëri kryetari se sa janë detyrimet e prapambetura...

Arben Ahmetaj – Nuk ka gjë, kur t'i bëj më vonë pyetjet.

Anila Denaj – Në rregull.

Se sa një sëmundje kronikë do të jetë në listën e barnave të reja, këtë mund ta dijë vetëm politika e re e barnave që fillon në fund të tetorit me çmimet e reja.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Suzana!

Suzana Topi – Pyetja e tretë ishte në lidhje me kategorinë e ndihmave ekonomike të personave me aftësi të kufizuara, a do të ketë ndryshime?

Anila Denaj - Në raport me PAK-un ka dy elemente: nga një njëra anë këtë vit është aprovuar një amendament me kosto në buxhetin e shtetit prej 200 milionësh dhe më tej në vitin 2020 prej 500 milionë lekësh, të cilat kanë të bëjnë me adresimin e çështjes së sigurimit të invalidëve, që ju mungon vjetërsia në punë për një periudhë të caktuar. Kjo është adresuar dhe, sigurisht, është një fond shtesë në buxhetin e ministrisë dhe e kemi rialokuar, duke filluar nga ky vit; edhe për vitin tjetër është e parashikuar në buxhet.

Për sa i takon nxitjes tjetër të politikave të ndihmës drejt personave me aftësi të kufizuara, më lejoni të them se nxitja nuk ka qenë vetëm duke dhënë fonde shtesë, por ka qenë edhe duke nxitur personat të aftësisë së kufizuar drejt punësimit. Kësaj i ka shërbyer edhe

ligji për punësimin, si rezultat i të gjitha përpjekjeve që janë bërë me deputetët për të sjellë një ligj, i cili do t'i çojë drejt tregut të punë personat të kësaj kategorie. Në rast se bizneset nuk do të arrijnë që ta adresojnë këtë kërkesë në nevojat e tyre të punësimit, sigurisht që duhet të plotësohet detyrimi ligjor për krijimin e fondit, i cili në vetvete nuk është objektiv i ligjit, por mund të krijojë fonde të tjera shtesë për të dresuar çështjet e personave.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje tjetër?

Suzana Topi – Në lidhje me subvencionet e fermerëve dhe për ato kategori fermerësh që humbasin prodhimet e tyre nga fatkeqësitë e madhe natyrore dhe për çmimin dysHEME të tregut, a do të ketë kompensime, apo jo?

Anila Denaj – Në lidhje me subvencionimin e fermerëve, parashikohet në vlerën e 850 milionë lekëve. Këtu bëhet fjalë edhe për skemën e qumështit, e cila do të fillojë këtë vit aplikimin me një kosto prej 300 milionë lekësh.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Unë i kam marrë zërat me tabelë.

Në analizën e shpenzimeve buxhetore që kam analizuar, sipas tabelave që ju keni sjellë, në pjesën më të madhe jam përqendruar tek ajo që zë 60% të buxhetit, pra shpenzimet buxhetore të ministrive të linjës dhe të institucioneve buxhetore, të cilat e kanë në total buxhetin 319 miliardë lekë, pra shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale. Me një sy të parë konstatoj (në fakt, kam marrë për referencë dhe kam bërë një tabelë krahasuese në lidhje me aktin normativ të vitit 2019, të cilin e miratua para 1 muaj)...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo akti normativ i vitit 2019, që ishte ndryshimi i buxhetit 2019 të planifikuar. Kështu që i jam referuar aktit normativ 2019 dhe buxhetit 2020 që keni propozuar. Kështu që analiza ime është ndalur në diferencat që kam konstatuar, të paktën në diferencat e rëndësishme në lëvizjet që ju keni bërë qoftë në rritje, qoftë në pakësim të zërave të ndryshëm buxhetorë. Ajo që mund të them në impaktin e parë është se në këtë pjesë të shpenzimeve buxhetore, që thasë se është gati 60% e totalit, ka një rënie të investimeve me 30 milionë euro dhe investimet korrente janë rritur me 108 milionë euro. Unë i bëj me euro, por, pak a shumë, 77 milionë është diferenca në rritje nga viti i kaluar.

Domethënë, pjesën kryesore në buxhet e zënë 11 ministrinë, e-qeverisja dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit zë 5% të buxhetit total vjetor, më e lartë se

sa 3 ministritë bashkë, e-qeverisja është 1,5% e buxhetit vjetor. Nuk i referohem GDP-së, por po marr përqindjen ndaj buxhetit vjetor. E-qeverisja ka pasur një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin e kaluar.

Meqenëse ministritë e linjës zënë pjesën kryesore të buxhetit, pyetjet e mia do të jenë atje ku diferencat nga viti 2019 me vitin 2020 janë më të rëndësishme.

Së pari, ajo që bie në sy është ulja e ndjeshme, me 5 miliardë lekë të rinj, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo është ministria që është prekur më shumë nga buxheti i vitit 2020. Buxheti i kësaj ministrie ka pësuar një rënie të madhe, pas asaj vjen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Ministria e Mjedisit, pra janë katër ministri që kanë më pak buxhet këtë vit se sa viti i kaluar. Këto fonde janë shpërndarë nëpër ministritë e tjera.

Më falni, se kam munguar herën e kaluar, kërkoj ndjesë, si mund ta konsiderojmë këtë buxhet të përqendruar, pra çfarë titulli mund t'i vëmë? Gjithsesi, po e nis nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, ku ju keni parashikuar rënie. Po merrem me zërat që kanë diferenca të ndjeshme, pra zëra materialë. Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes ka 380 milionë më pak investime për këtë vit. Pra, janë parashikuar shumë më pak fonde për infrastrukturën e kullimit dhe të ujitjes, ndërkohë që Shqipëria dihet që vazhdon t'i ketë një nga problemet më të ndjeshme përmytjet e dimrit. Të gjitha këto janë çështje sensitive, ku mendoj se buxheti duhet t'i shtojë fonde për ta përmirësuar dhe për ta zgjidhur situatën. Ndërkohë që jemi në kushtet që në vitin 2020 kemi një pakësim të zërit të investimeve, por edhe të shpenzimeve korrente me 380 milionë lekë të rinj.

Ndërkohë, keni parashikuar një rritje të investimeve si mbështetje për peshkimin. Pra, janë 626 milionë lekë plus, sepse në total janë 902 milionë, investime për mbështetjen e peshkimit. Konkretisht, çfarë përfaqëson kjo rritje? Çfarë projekti konkret e prek këtë zë, që ka një rritje kaq të ndjeshme? Ajo që bie në sy është te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku 5 miliardë lekë më pak do të ketë në dispozicion për vitin 2020. Ai që preket më shumë është transporti rrugor, gati 3 miliardë më pak në transportin rrugor, që do të thotë se parashikohen më pak investime në transportin rrugor. Gjithashtu, në furnizimin më ujë dhe kanalizime janë 341 milionë lekë më pak investime; në menaxhimin e mbetjeve urbane janë 300 milionë lekë më pak dhe në mbështetje për energjinë janë 1,8 miliardë lekë më pak. Kjo ministri është prekur në zërat kryesorë, prandaj dua të di si është gjykuar dhe pse është vlerësuar një rënie dhe pakësim kaq i fortë i fondeve për këtë ministri dhe në këto zëra, si: transporti rrugor, furnizimi me ujë dhe kanalizime, si dhe menaxhimi i mbetjeve urbane dhe

mbështetja për energjinë. Për këta 4 zëra fondet, qoftë për investime, qoftë për investime korrente, janë pakësuar në mënyrë të ndjeshme, prandaj dua një përgjigje për këtë pakësim fondesh në këto zëra.

Anila Denaj – Le të biem dakord që asnjë metodologji nuk ka të re në shkurtimin e zërave buxhetorë, sikurse çdo vit projektet, të cilat avancojnë më mirë nuk preken edhe në momente kur të ardhurat mund të kenë rishikim nga i pritshmi te referenca e parashikimit në fillim të vitit. Çdo akt merr në bazë pikërisht ecurinë e projekteve kur vendos rialokime për projekte të tjera të rëndësishme. Kjo ka qenë baza, është dhe do të jetë në raport me buxhetin. Sigurisht, tavanet vendosen sipas qasjeve sektoriale dhe prioriteteve sektoriale, që vendosen në nivel më të gjerë se sa vetëm në ministri, kjo është në kuadër të të gjithë qeverisë, por brenda tavanëve, nëse një ministri gjykon që mund të ketë rialokim të fondeve nga një projekt, i cili mund të mos rezultojë brenda vitit dhe, në mungesë të djegies së fondeve ta rialokojë atë në një projekt siç është peshkimi, besoj se është në gjykimin e ministrisë përgjegjëse që ta bëjë atë. Kjo ishte në parim të përgjithshëm të faktit pse ka rialokime dhe, sigurisht, pse ka shkurtime nga parashikimi i fillimit të vitit. Ne kemi adresuar në komision një nivel më të ulët të ardhurash. Sigurisht, në qoftë se do të ulen të ardhurat dhe brenda kuadrit të ruajtjes së parametrave fiskalë, të cilët janë një angazhim jo vetëm i Ministrisë së Financave, por i të gjithë qeverisë drejt deficitit buxhetor dhe konsolidimit të borxhi drejt uljes, detyrimisht do të dojë që të kërkojë një shkurtim apo një ngrirje të shpenzimeve, në mënyrë që përtej fondeve të kontigjencës të kesh mundësi të përdorësh edhe fonde të tjera, të cilat do të realizojnë këtë synim. Kjo nënkupton që dy janë burimet kryesore, ku mund të preken projekte të madha, ato të rrugës dhe fondit të zhvillimit, i cili, duke pasur një fond të konsiderueshëm, bëhet subjekt edhe i diskutimit qoftë të ecurisë së projekteve, nëse është duke ecur me ritmin e duhur deri në fund të vitit, sidomos për atë me mbështetje buxhetore, ashtu edhe në faktin nëse ka hapësira për të ndërhyrë. Kjo është arsyeja pse infrastruktura dhe FSHZH-jatë janë dy subjekte që kanë marrë prekjen më të madhe. Sigurisht që kjo nuk ka qenë në dëshirën e përgjegjësve të dy institucioneve, por ka pasur mirëkuptim për këto objektiva që thamë pak më lart.

Për sa i takon pjesës së bujqësisë, ne mund t'i shohim zë më zë, listën e kemi, por fjalën dua t'ia kaloj zonjës Dhëmbi të sqarojë pjesën, të cilës i bëhet referencë me fondet respektive

Mimoza Dhëmbi- Atëherë, investimet në sektorin e bujqësisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse shohim investimet e bujqësisë, ka disa programe që kanë shtesë dhe disa programe që kanë ulje në raport me aktin normativ. Në total buxheti i Ministrisë së Bujqësisë është 1,7 miliardë më i lartë dhe kjo tregon se ky hyn në sektorët prioritarë. Fakti që buxheti ka lëvizur nga menaxhimi i infrastrukturës së kullimit të zhvillimi rural është se ka një projekt, i cili ka të bëjë me ndërtimin e disa kanaleve ujitës dhe kullues nga bashkitë dhe mund të jetë çështje riklasifikimi të këtij fondi, sepse, nëse e vini re programin të zhvillimi rural ai ka një rritje prej 1 miliardë lekësh, ndërkohë që te programi i menaxhimit të ujitjes dhe kullimit është minus 380 milionë.

Është e vërtetë që mbështetja për peshkimin ka një rritje, por shpeshherë rritja në programe specifike lidhet me projekte specifike. Për shembull, nëse ka një projekt të IPA-s ose një financim të huaj konkret, shohim se financimi i huaj shpeshherë bën dallimin nga programi në program dhe nga viti në vit dhe, nëse në një sektor të caktuar vjen një projekt i ri, nga një mbështetje minimale në atë sektor, menjëherë futja e një projekti të huaj e rrit totalin e programit, sepse këtu janë të dyja, të huaj dhe të brendshme. Duke i parë projektet në detaje, te mbështetja e peshkimit shohim që kemi dy projekte ndërtimi. Projekti i parë është ai i tregut të peshkimit në Vlorë, i cili është një projekt në vazhdim, me rreth 80 milionë lekë, projekti në Shëngjin, i cili ka përfunduar, si dhe kemi disa investime për thellim portesh. Këto janë prioritetet e Ministrisë së Bujqësisë, e cila ka gjykuar që këto investime janë të nevojshme për të zhvilluar sektorin e peshkimit. Kemi edhe një projekt peshkimi të IPA-s dhe një projekt i ri “Mbështetje për zhvillimin e tregjeve dhe prodhimitarisë detare”, që është gjykuar nga Ministria e Bujqësisë që të fillojë këtë vit.

Lidhur me rënien e fondeve për Ministrinë e Drejtësisë, dua të theksoj se këtu ka një ndryshim strukturor, ku agjencia e ALUIZNI-t është bashkuar me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive dhe janë bërë institucion jobuxhetor. Pra, e gjithë kostoja e ALUIZNI-t, e cila ka pasur mbi 500 milionë lekë, është hequr nga buxheti dhe është bashkuar me një agjenci, e cila është me vetëfinancim, pra, financohet nga tarifat që kanë të bëjnë me procesin e legalizimit dhe me tarifat që kanë të bëjnë me regjistrimin e pasurisë. Ky është një kursim i konsiderueshëm dhe nuk është ulje në sistemin e drejtësisë, sepse ndonjëherë japim mesazhe të gabuar, por ky është një ndryshim strukturor.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Arben Ahmetaj – Është me persona dhe jo me tema. Të mbarojë opozita, sepse duhet respektuar dhe të vazhdojë pozita.

Edlira Hyseni – Faleminderit, kryetar!

Ju na shpjeguat se për shkak të performancës jo të mirë, ose për shkak të mosqenies më prioritet, janë ulur fondet për infrastrukturën rrugore, për ujin, kanalizimin, përmbytjet dhe mbetjet urbane. Të gjitha këto janë bërë, sepse nuk gjykohen se kanë qenë shumë të suksesshme, nuk kanë pasur një performancë të mirë dhe që as nuk janë në këtë moment një prioritet dhe janë rialokuar fonde, duke drejtuar zëra të tjerë?! Kjo ishte arsyeja pse janë bërë këto ulje apo sepse buxheti është orientuar në ministri të tjera, si: në arsim dhe shëndetësi, të cilat janë gjykuar më të rëndësishme këtë vit sesa në vitet paraardhëse? Nuk e di nëse e kuptova unë kështu, apo e kam të paqartë?!

Anila Denaj- Unë në asnjë moment nuk fola për rialokim, për arsye të rëndësishme të ndryshme që ka një ministri nga tjetra. Sigurisht, ka angazhime, siç është angazhimi drejt Ministrisë së Mbrojtjes, ka angazhime ndaj shërbimeve të qytetarëve dhe ndaj marrëdhënieve, të cilat lidhen me segmente të caktuara të popullsisë, të cilat janë detyrime ligjore dhe këto prevalojnë. Ndërkohë, nëse këto prevalojnë dhe kemi projekte infrastrukturore, të cilat, për arsye të të njëjtës metodologji që ka qenë çdo vit në Ministrinë e Financave, ku performanca, për arsye më të ndryshme, mund të jetë për performancë procedure, ose për performancë me arsye të tjera, tregon që nuk ka mundësi që të përfundojë deri në fund të vitit, sigurisht që këto riallokohen. Ky tregues përdoret si bazë edhe për vitin tjetër, kur vendos që duke bërë një akt normativ ke hequr disa fonde buxhetore dhe i ke çuar drejt projekteve më të avancuara. Ndërkohë, pak më parë u tha që ka projekte, të cilat në raport edhe me financime të jashtme, mund të kenë marrë një vemendje dhe parashikohen për vitin tjetër.

Nuk dua të ngelem tek të ardhurat, sepse ne e kemi trajtuar ato gjerësisht, por nuk do doja të kishte një keqperformancë terminologjie për të ardhurat, sepse ajo është e lidhur me shumë arsye, të cilat janë adresuar. Nëse flasim për keqperformancë, duhet të flasim për keqadministrim dhe ky nuk është argumenti. Sigurisht aty ka elemente të administrimit, të cilat duhet të përmirësohen dhe kjo është në fokus të ministrisë dhe të projektbuxhetit, por arsyet e parashikimit dhe pritshmërisë nuk lidhen me këtë proces.

Edlira Hyseni – Një pyetje tjetër. A është i parashikuar në investime apo shpenzime korrente, nuk e di ku hyn, premtimi i bërë kohët e fundit nga Kryeministri për parkun ekologjik, ose zgjidhjen e problemit të mbetjeve urbane që ka qyteti i Durrësit? Ai është një projekt që duhet të kishte filluar, por në dijeninë time nuk ka filluar ekzekutimi dhe zbatimi i tij. A është planifikuar konkretisht në vitin 2020 për t'u nisur dhe për t'u përfunduar në kohë? Unë nuk e kam identifikuar se në cilin zë është.

Anila Denaj – Po, është.

Arben Ahmetaj- Edhe një herë për mediet. A është parku ekologjik zgjidhja e çështjes së landfillit të Durrësit?

Anila Denaj- Po, është i parashikuar konkretisht në zërin me fondin 564 milionë lekë.

Edlira Hyseni – Pyetja tjetër. Ndoshta është shumë e thjeshtë, por më ra në sy rritja nga vitit 2019 në vitin 2020 të Ministrisë së Financave e zërit për sigurimin shoqëror me 3,5 miliardë lekë më shumë dhe për shërbimin e kujdesit dytësor me 1,7 miliardë lekë. Pra, në krahasim me vitin 2019, janë rritur dy zëra, ai për sigurimin shoqëror, që është pjesë e Ministrisë së Financave, dhe shërbimin e kujdesit dytësor, që është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë. Nga rrjedh një rritje kaq e ndjeshme e zërit?

Anila Denaj – Ju e keni në raport me parashikimin. Faktikisht në projektrelacion, në faqen 32, është e gjithë tabela, e cila përcakton se sa janë të ardhurat nga kontributet dhe sa janë shpenzimet me financime nga buxheti, të cilat nga 48,7 për këtë vit, shkojnë në 51,3 miliardë lekë për vitin tjetër, dhe kontigjencat për politika pensionesh, e cilat ngelet për indeksimin e çmimeve në nivelin 2,5 nga 2,4 të parashikuar në vitin 2019.

Edlira Hyseni – Dua t'i rikthehem edhe një herë asaj që thashë në fillim lidhur me e-qeverisja, që nuk e kam të qartë. Për çfarë i përdor, si menaxhohet, si administrohet dhe në çfarë konsiston ky buxhet i lartë, i cili është 1,5%? Në buxhetin e parashikuar e-Qeverisja ka buxhet sa për dy ministri bashkë, të cilës i parashikohet një rritje e ndjeshme në investime dhe në shpenzime korrente, gjithmonë me parashikimin në aktin normativ 2019. Pse u kushton e-Qeverisja shqiptareve kaq shumë dhe pse zë kaq shumë peshë në buxhetin vjetor, në çfarë konsiston konkretisht dhe a është një qeveri paralele *online*, e cila zëvendëson punën që nuk bëjnë ministrinë apo institucionet e tjera? Më falni.

Arben Ahmetaj – Pyetja juaj është korrekte dhe në linjë me futjen e teknologjisë në jetën e vendit. Ju falënderoj për pyetjen!

Anila Denaj- Sigurisht, zëri i buxhetit që i akordohet AKSHI-t zë një zë të konsiderueshëm dhe mund të jetë krahasimisht me atë të një ministrie, por, në fakt, është një ndryshim procedural i ndodhur para dy vjetësh, ku zërat e investimeve kapitale, qoftë atyre për mirëmbajtje, ashtu edhe atyre për projekte, të cilat kanë të bëjnë me teknologjinë e informacionit, janë centralizuar në një ent që quhet AKSHI. Sigurisht, gjatë kësaj periudhe 2-vjeçare ministrinë e linjës nuk duhet të prokuronin dhe nuk kanë prokuruar për projekte të teknologjisë së informacionit dhe ai zë buxheti, që ndër vite ka qenë për t'u adresuar në

investime në teknologji të informacionit, është transferuar dhe do të vijojë të buxhetohet për këtë institucion. Çfarë synohet me këtë?!

Së pari, synohet që të ketë një programim më të mirë të të gjitha politikave të të ardhmes drejt informacionit të centralizuar në një format, që sot flitet gjithnjë e më shumë për një teknologji më të avancuar, për shërbime *online*, për shërbime të marra në kohë reale dhe për shërbime të marra pa kontaktin e drejtpërdrejtë, të cilat kanë një kosto të caktuar. Kjo kosto duhet krahasuar me të gjithë zërat që kanë pasur në vite çdo ministri për sa i takon zërit të IT-së, mirëmbajtjes dhe projekteve. Pasi të hiqet nga të gjitha këto, mund të flasim nëse është e krahasueshme. Ky proces tranzitor prej dy vjetësh me rialokim të përgjegjshmërisë, por njëkohësisht edhe të buxheteve është shoqëruar edhe me diskutime të tipit, si: sa janë këto projekte, cilat projekte janë nisur dhe akoma janë për t'u paguar nga AKSHI, gjë që sjell shqetësime në lidhje me disa detyrime të prapambetura, të cilat po adresohen në një kontekst buxhetor si për të zgjidhur këtë detyrim, ashtu edhe për të mundësuar që projekte në nivel afatmesëm për teknologjinë e informacionit të jenë në linjë me politikat afatmesme të qeverisë për shërbime *online* për të gjithë popullsinë.

Arben Ahmetaj- Vazhdo.

Edlira Hyseni- Mendova se po bëhem e bezdisshme dhe nuk doja...

Arben Ahmetaj- Zonja deputete, këtu jeni për të bërë pyetje, për të komentuar, për të mbajtur qëndrime dhe për të votuar. Kështu që jeni brenda procedurës suaj dhe mund të bëni pyetje sa të doni.

Edlira Hyseni - Ju faleminderit, kryetar!

Unë kthehem te Fondit i Zhvillimit Shqiptar, i cili nuk ka rritje, por rënie të vogël me 147 milionë lekë, nëse nuk gabohem, por në total zë gati 5% të buxhetit, ku janë pak a shumë 125 milionë euro. Ky është një buxheti i konsiderueshëm, i rëndësishëm dhe absolutisht i domosdoshëm për projektet që ka, por për momentin nuk kam një tabelë përmbledhëse të detajuar. A mund të kemi një informacion nëse ka të reja dhe çfarë ka në vijim për të justifikuar 5%-in e buxhetit që kemi, që është 4,3 miliardë euro, nëse nuk gabohem?

Pyetja e fundit. Ju e thatë vetë në fillim që nuk është i parashikuar edhe për këtë vit fondi për rritjen e pagave të administratës. Duhet të jetë fondi 2 miliardë që hoqi akti normativ i vitit 2019, i cili u rishikua dhe u bë 0. Pra, fondi për politikat e reja të pagave ka qenë 2 miliardë lekë në buxhetin e vitit 2019, me aktin normativ u bë 0 dhe vijon të jetë 0. Me sa pashë edhe në buxhetin afatmesëm, i njëjti fond vijon të mbetet 0 edhe për vitin që

vjen. Pra, nuk parashikohet një politikë rritje pagash as për këtë vit dhe as për vitin që vjen. Më duket se e kishit parashikuar për në vitin 2022. Pra, do të pranojmë që nuk është momenti për ekonominë dhe për një milion arsye që keni t'u themi njerëzve, të cilët punojnë në shtet, se nuk do t'u rriten pagat dhe jemi dakord se do t'u vijë keq të gjithëve. Tani jemi në një moment fushate sensibilizimi, rivlerësimi, antiinformaliteti, ku i kërkohet biznesit privat të rishikojë pagat e deklaruara. Administrata tatimore po u çon njoftime *online* të gjithëve, pavarësisht pagave që kanë. Unë kam pasur rastin të shoh biznese të të njëjtit sektor, ku njëri e deklaronte 50 mijë pagën, kurse tjetri 30 mijë, por u shkon i njëjti informacion. Pra, nuk ka një standard se kujt i referohen. Në kushtet kur ne pranojmë se vetë shteti nuk i rrit dot pagat, sepse ekonomia nuk e lejon, pse mendoni se biznesi privat duhet patjetër të rrisë pagat e veta dhe çfarë do të merrni si referencë, sepse tregu është shumë i gjerë? Cilat paga do të merrni si referuese? Ju siguroj se një shofer në Durrës mund të marrë 40 mijë, ashtu sikurse mund të marrë 50 mijë apo 30 mijë. Si do t'i lejohet administratës tatimore të bëjë rivlerësimin e pagave në mënyrë subjektive dhe t'i kërkojë biznesit të rrisë pagat, kur vetë shteti nuk parashikon rritje pagash për dy vjet?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Në raport me FZSHSH-në listën e kemi shteruese në aneks dhe mund të adresojmë krahasimisht se cilat janë projektet e reja ndaj atyre që janë në vijim. Unë mund të them më bindje që ky vit, të paktën tani që kam marrëdhënie të drejtpërdrejta me drejtuesin e FZSHSH-së, ka rialokuar në mënyrë të konsiderueshme buxhetet brenda tavaneve buxhetore për të ekonomizuar të gjitha tavanet dhe për të përfunduar projektet ekzistuese. Ky proces, sidomos për zhvillimin e zonave të caktuara rurale dhe integrimin e tyre brenda një kuadri më të gjerë të zhvillimit ekonomik, por edhe të turizmit e të agroturizmit, besoj se meriton këtë buxhet për ta adresuar në kohë dhe me efektivitet.

Për sa u takon rrogave në administratën publike, fondi prej 2 miliardë lekësh, e thashë edhe në fjalën time në fillim, u përdor për rritjen në prill të këtij viti të fondit të pagave për një grup të caktuar punonjësish të administratës publike. Ky fond do të vijojë edhe vitin tjetër dhe amortizon jo vetëm pjesën e nevojës së këtij viti, por edhe nevojat shitesë në fushat ku është prekur këtë vit me 1 miliard lekë. Pra në total është një shumë prej 3 miliardë lekësh e integruar. Është e nevojshme të themi që ky fond është i qenësishëm, sepse nuk kthehet mbrapsht një e drejtë e dhënë.

Në raport me krahasimin që bëni, me lejon të them që janë dy baza të ndryshme. Nëse flasim për rritje të rrogës tek administrata publike në referencë të asaj që thashë më parë dhe të asaj që ju vetë thatë, që ka fonde të konsiderueshme për pagesat dhe sistemet online, në çdo logjikë administrative, qoftë të administratës publike apo private, çdo përmirësim sistemesh duhet të shoqërohet me një analizë të sistemeve të burimeve njerëzore, për të lejuar rialokim të shërbimeve, pa prekur apo cenuar numrin. Por për këdo që ka përvojë në administratë private kjo do të shoqërohej edhe me shkurtim. Ne nuk po flasim për shkurtim, nuk po flasim për ulje, por për një rialokim të shërbimeve drejt shërbimeve më të mira dhe të integruara, por sigurisht kërkohet dhe një analizë e mirë e të gjitha kategorive, që të kemi një ndarje më të mirë dhe një qasje më harmonike të të gjitha kategorive të punës përpara se të vendosim pas një viti nëse do të ketë apo jo rritje dhe kush do të ketë. Të marrësh frymë për të vendosur për të bërë analiza dhe për të bërë një herë në dy vjet rritje pagash është një politikë e kujdesshme dhe bashkëkohore.

Në raport me krahasimin që ju bëtë me dypunësimin, dua të them që janë dy gjëra të ndryshme, sepse flasim për një logjikë të rritjes së pagave brenda një afati 1 apo 2 vjeçar në bazë të një analize, pjesa tjetër është procedurale dhe nuk ka të bëjë me rritjen e pagave, por me qartësimin e dypunësimit në raport me deklarimin e një taksimi të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai është një proces i vazhdueshëm.

Arben Ahmetaj – Shtypeni mikrofonin që të regjistrohet pyetja juaj!

Edlira Hyseni – Unë akoma nuk e kam të qartë. Administrata Tatimore i kërkon biznesit që të deklarojë pagën e vërtetë, pra e merr të mirëqenë që nuk janë pagat reale ato që po deklarohet dhe kërkon rritje pagash, nuk po u thotë për ulje pagash, se po flasim për ato paga që duhen rritur. Jemi në kushtet e një ekonomie që nuk po shkëlqen, nuk po rrezaton.

E para, nuk mendoj se është koka t'i thuhet biznesit të rrisë detyrimisht pagat, se përndryshe do të rivlerësohet nga zyrat, në një kohë kur vetë shteti nuk po rrit pagat e veta.

E dyta, cila bazë ligjore do të merret parasysh që të ndani pagat e biznesit privat sipas sektorëve, rretheve, kategorive, arsimit etj, se ka qenë një VKM e vitit 2010 që është shfuqizuar, pra nuk kemi në fuqi një VKM që ka disiplinuar pagat e tregut privat...

Arben Ahmetaj – Më falni, ju lutem!

Nuk iu referua ministrja ndonjë...

Edlira Hyseni – Nuk mu përgjigj.

Arben Ahmetaj – Kur nuk përgjigjet ministrja, që e ka në legjitimitetin e vet dhe ju mund të thoni prapë që ministrja nuk mu përgjigj për 1, 2, 3, apo 4 pyetje, ne nuk mund të vëmë fjalë në gojë të ministres, sepse ajo është politikë dhe për mua është politikë agresive, dhe, në këndvështrimin tim, ta vendosësh atë politikë në gojën e qeverisë është e gabuar. Ministrja nuk tha që ne do të vëmë paga reference në sektorin privat. Qeveria, ministrja, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk simulon.

Zoti Roshi, ju lutem!

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën një analizë të pagave në sektorin privat dhe në bazë të kësaj analize, që e bën pothuajse çdo vit, del rezultati, i cili në këndvështrimin e DPT-së, duke iu referuar dhe pagave mesatare në sektorë për funksione dhe pozicione.... për shembull, një inxhinier në një kompani, merrte 370 mijë lekë të vjetra, e kam parë vetë *payroll*-in, listëpagesën. Nuk janë raste, por për fenomene, dhe si të tilla ministrja iu referua një qasjeje kundër informalitetit në total dhe specifikisht për pagat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, mos debaton shkaku, se shkaku dihet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi qetësi? Zoti Roshi, ne do të rrimë këtu deri në 10 të natës derisa ju të keni mbaruar dhe fjalën e fundit. Ti do të ikësh më shpejt se ke punë, por ne që nuk kemi punë do të rrimë.

Pra, shkaku është evazioni dhe ndërkohë ministrja merret me shkaku, duke detyruar administratën për edukimin e tatimpaguesve edhe lufton evazionin nipt për nipt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk tha rivlerësime. I bën thirrje tatimpaguesit të deklarojë realen, nëse jo, ligji i procedurave dhe ligji “Për të ardhurat personale” i kanë të qartë procedurat. Kur të kalojmë nën për nën, nëse doni procedurat jua them tani se çfarë ndodh dhe sa është gjoba, por nuk jemi duke folur për këtë. Ju po i kërkon ministres çfarë do të bëjë ajo që ta rrisë pagën në sektorin privat për Ben Ahmetaj, që punon në një kompani IT-i apo ndërtimi.

Të fokusohemi te fenomenet!

Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Nëse ju i bëni referencë njoftimeve që vijnë nga administrata tatimore dhe nxirrni konkluzione në bazë të një biznesi të caktuar, me lejoni t’i bëj unë një referencë

faktit pse gjykojmë që ky nuk është një proces ndaj një biznesi apo një sektori. Ne monitorojmë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha inspektimet në tregun e punës. 47% është në raport me numrin e inspektimeve masa e gjetjeve. Ky është fenomen. Nëse 47% e të gjitha inspektimeve konsistojnë në deklarime poshtë realitetit, në masa më shkelje të Kodit të Punës, atëherë besoj se kjo do t'ju shqetësojë, si ju, ashtu dhe ne, dhe nuk ka të bëjë me faktin pse vjen një njoftim. Njoftimi vjen kur fenomeni konstatohet në mënyrë të qenësishme. Sigurisht që masat administrative bëhen në bazë të një metodologjie risku dhe nuk vendosim dot sot se cila do të jetë kjo metodologji, sepse nuk besoj se administrata tatimore ka burime të mjaftueshme për t'i vizituar të gjithë, por nuk është një apo dy raste, por një numër i konsiderueshëm.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, Administrata Tatimore i ka të gjitha mundësitë dhe metodologjinë e riskut, e ka bërë dhe do ta bëjë në vazhdimësi, pra në bazë të platformës së menaxhimit të riskut, ku kapen shpenzime dhe brenda shpenzimeve kapen shpenzimet e personelit, brenda shpenzimeve të personelit kapen funksione të veçanta, pastaj kapen edhe kompani të veçanta, të cilat krahasohen dhe automatikisht del një mesatare e sektorit dhe deformimet nga kjo mesatare, si dhe mesatarja në kompani ndërkombëtare të audituara ndërkombëtarisht për të njëjtat funksione. Administrata tatimore, nëse do, nxjerr konkluzione të drejtpërdrejta edhe kuantitative, madje i ka edhe nipt për nipt kompanitë e mëdha, sidomos për 9 mijë kompanitë aktive në TVSH.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, nuk po marrin pagë reference fiskale, por po marrin pagë reference të referuar në gjetje dhe në fakt. Çfarë do të thotë? Kemi një fakt ku inxhinierët marrin nëpër industri 900 mijë lekë të vjetra, ndërkohë kemi devijim që marrin 400 mijë lekë. A ka inxhinier që merr 400 mijë lekë? Nuk është e mundur. Aty DPT-ja bën punën e vet në bazë ligjit, nuk ka nevojë për VKM, se jemi në luftë kundër evazionit.

A ka pyetje tjetër nga pozita?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të kthehemi prapë të ju, zoti Roshi, të premtoj që nuk do të ikim pa bërë të gjitha pyetjet! Do të mbajmë procedurën, por nuk do të ikim nga komisioni pa i bërë të gjitha pyetjet që keni në mendje, ose të shkruara.

Ju lutem, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse këto vitet e fundit në vendin tonë ka pasur disa tërmete dhe përmytje në zonat jugore nga lumenjtë, unë doja të dija sa e keni parashikuar fondin për emergjencat civile dhe, duke pasur parasysh 7 milionë eurot e prapambetura nga ato të palikuidurat nga Ministria e Mbrojtjes dhe DEC-i? Përveç tërmetit që ka rënë në Durrës, në Korçë, në Vlorë kanë rënë dy tërmete, një më muajin maj në krahinën e Smokthinës 4,8 ballë, dhe tjetri në Kuç të Vlorës, edhe ai në këtë shkallë rihter, të cilat kanë shkaktuar dëme dhe banorët janë të pakompensuar për vlerën e dëmit, madje ka shtëpi të rrënuara dhe familje në vështirësi. A keni parashikuar të Fondi i Rezervë një vlerë të plotë për t'u ardhur në ndihmë banorëve të këtyre zonave, që kanë pasur këto probleme, njëkohësisht edhe banorëve, që kanë pasur përmytje nga lumenjtë të tokave të tyre?

Zonja Ministre, pyetja e dytë është ndoshta nga ato të mëparshmet, ka lidhje me një vlerë për skemën në bujqësi të fermerëve, që shkon në 850 milionë lekë. Unë dua të di ku e keni mbështetur këtë vlerë? E keni mbështetur në kërkesën që ka bërë Ministria e Bujqësisë....

Arben Ahmetaj – I lutem komisionit të mbajë qetësi, se po bën pyetje deputeti!

Vullnet Sinaj – E keni mbështetur në krahasimin me skemat që kanë fqinjët tanë në Ballkan? Për mua është e domosdoshme që skemat e mbështetjes së fermerëve të bujqësisë të shihen edhe me skemat që kanë fqinjët tanë, për arsye të konkurrencës në tregun bujqësor.

Do të thosha që nga të ardhurat, kur diskutuam në mbledhjen e parë, ju keni parashikuar rreth 20 miliardë të ardhura më shumë nga tatim-taksat dhe nga doganat. Ku e keni parashikuar se do të investohen këto të ardhura më tepër që do të hyjnë në buxhetin e shtetit të vitit 2020?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Sinaj, e kam për sqarim për vete. Pyetja e fundit kishte lidhje me të ardhurat?

Vullnet Sinaj – Tek të ardhurat Ministria e Financave ka parashikuar që për vitin që vjen...

Arben Ahmetaj – Në respekt të procedurës sot kemi shpenzimet.

Vullnet Sinaj – Unë thashë ku do të shpenzohen këto të ardhura të tepërta që kanë për të hyrë në buxhetin e shtetit vitin që vjen. A ka ndonjë parashikim shpenzimesh për të ndihmuar sektorë të ndryshëm të ekonomisë, ose për rastet që unë përmenda, pra Emergjencat Civile dhe ndihmën e banorëve në vështirësi për shkak të tërmeteve, apo për ndihmën që mund t'i jepet spektroren e bujqësisë, një nga sektorët që e dimë që

subvencionohet në të gjithë botën? Të gjithë duam të hamë, kemi detyra të ndryshme për të bërë, si deputet, ministër, apo pozicione të tjera, por atje është një pjesë njerëzish që merren me bujqësi dhe na japin në të gjitha ushqimet. Ata njerëz që merren me ferma, me bujqësi e me blegtori kanë nevojë për subvencion dhe mua më duket vlerë e vogël kjo për ta. Do të thosha që ju duhet ta rishikoni këtë gjë, prandaj ju pyeta ku e keni bazuar, te kërkesat e Ministrisë së Bujqësisë, e keni bazuar të nevojat, apo të tregu? Pra duhet parë, prandaj fola për të ardhurat e tepërta të parashikuara. Le të shpenzojmë në ato sektorë të ekonomisë që duhen për t'i ardhur vërtet në ndihmë ekonomisë së vendit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Më fal, për ta orientuar te shpenzimet, a keni ndonjë propozim konkret?

Vullnet Sinaj – Po.

Arben Ahmetaj - Bëjani pyetjen ministres!

Vullnet Sinaj – Për pjesën e subvencioneve, ose të skemës së fermerëve, do të thosha se është një shifër e vogël, por edhe sikur të dyfishohej do të ishte pak për mua. Po të shkonte në 20 milionë euro më tepër do të ishte një shifër më se e domosdoshme për tregun në bujqësi.

Kurse për pjesën e Emergjencave Civile pres përgjigjen që do të më japë ministrja, pastaj do të bëj propozimin.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Dakord.

Faleminderit!

Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – Në raport me Fondin e Emergjencave Civile dhe me nevojën për të adresuar aty të gjithë kontigjencën e kërkesave, të cilat vijnë nga tërmeti i fundit dhe nga tërmetet e mëparshme, me lejon të them që metodologjia e pagesës vjen në bazë të një pune administrative për verifikimin e dëmit, konstatimin dhe pagesën. Ne, në projektbuxhetin e këtij viti kishim, përpara shtatorit, 130 milionë lekë në Fondin e Emergjencave Civile, i shtuam 470 milionë lekë nga Fondi Rezervë në fund të muajit të kaluar, për të mundësuar pagesën e detyrimeve që lindin nga tërmetet dhe jo vetëm nga ai i muajit shtator.

Sigurisht nevoja për fonde të tjera nga fatkeqësitë natyrore duhet të parashikohet. Ato janë të lidhura me tërmetet, të cilat janë të vështira për t'u parashikuara, por edhe me elemente të tjera si, infrastruktura për mbrojtjen nga përmbytjet, apo fondi që iu është dhënë

bashkive. Rehabilitimi i digave është po aq i rëndësishëm për të parandaluar dhe për të reaguar.

Konkretisht për vitin 2020 Fondi i Emergjencave Civile është parashikuar të jetë 315 milionë lekë, Fondi i Infrastrukturës së Mbrojtjes nga Përmbytjet brenda Ministrisë së Bujqësisë është 390 milionë lekë dhe fondi që iu është dhënë bashkive për të gjithë rehabilitimin e digave dhe ujëmbledhësave është 1 miliardë lekë, konkretisht në zona të veçanta, si Tapizë, Shoshaj, Kurian, Paskuqan etj.

Arben Ahmetaj – Zonja Dhëmbi, po flet ministrja.

Anila Denaj - Me këtë dua të them që fondet nuk janë asnjëherë të mjaftueshme, të cilat sigurisht që miradministrohen nga Fondi i Emergjencave Civile për pagesa sipas procedurave. Unë nuk mund të them sot se cilat procedura janë konkluduar dhe sa janë paguar, por fondi është 315 milionë dhe është shtuar në krahasim me vitin 2019.

Për sa i takon skemës së subvencioneve, bujqësia është një sektor prioritar i zhvillimit ekonomik të vendit, por po t'i hyjmë një analize të zhvillimit të bujqësisë mendoj se kemi ende shumë për të bërë për ta kthyer atë një sektor modern zhvillimi. Në këtë aspekt nuk mjafton vetëm mbështetja buxhetore, edhe mënyra se si i gjithë sektori mund të zhvillohet drejtë skemave të krijimit të vlerës më të shtuar dhe rritje së konkurrueshmërisë, por dhe të shkëputjes nga varësia e madhe që ka segmentimi në këtë sektor, që e ul në mënyrë të ndjeshme konkurrueshmërinë. Me 1,2 ha për fermer ka shumë pak mundësi të flasim për bujqësi moderne. Nxitja drejt skemave *value chain*, pra në të gjithë zinxhirin e vlerave është një skemë shumë e rëndësishme, e cila nuk është konkluduar ende, por do të ishte e vetmja që do të mundësonte investime si te IPART-it ashtu dhe të skemave të tjera për të cilat qeveria shqiptare është angazhuar të ndihmojë.

Referencë të mbështetjes së skemës ne u bëjmë të dhënave që disponojmë si në Ministrinë e Financave, ashtu dhe në Ministrinë e Bujqësisë. Këto të dhëna, edhe kur folëm për të ardhurat, shpesh janë të ndryshme nga një ministri te tjetra.

Ministria që ne përfaqësojmë, duke qenë se ka administruar disa të dhëna në aspektin fiskal, sigurisht të dhënat, në raport me numrin e fermerëve që mund të mbështeten, janë çuditërisht më të vogla se kërkesa që vjen nga Ministria e Bujqësisë, çka flet edhe një herë për informalitetin që ekziston në këtë sektor. Por kjo nuk do të thotë se skemat e subvencioneve të mos mbështeten. 850 milionë është një skemë e rritur, por duhet ta shohim më gjerë se një subvencion, pra të shohim se si kanë funksionuar të gjitha skemat kombëtare, kontestin e tyre, skemat IPART-it se si po përthithen dhe skema e aksesit në financë, ajo e

BERZH-it. Qeveria shqiptare aktualisht është me një angazhim prej 36 milionë eurosh prej të cilave 15,2 milionë euro janë aktualisht të depozituara për të krijuar mundësinë e një kreditimi të lehtë, si rezultat i një skeme mbështetjeje të të gjithë kreditimit ku mungon kolaterali. Aktualisht janë 40 milionë euro të disbursuara nga kjo skemë. Fola pak gjatë për të thënë se është më komplekse se vetëm një subvencion te fermeri në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Edhe TVSH-ja zero e imputeve prej 1,5 miliardë lekësh, që këtë vit nuk e vendosëm në buxhetin e shtetit, është një skemë subvencioni dhe nuk mund ta lëmë pa përmendur pavarësisht se vjen në një formë tjetër.

Vullnet Sinaj – A keni ndonjë propozim tjetër? A mund të vazhdojmë? Dua të vazhdoj me propozimin dhe me diçka tjetër.

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Vullnet Sinaj- Zonja Ministre, unë kur kam parasysh fermerët, nuk kam vetëm ata që punojnë në bujqësi, por kam edhe blegtorët. Në zonat malore dhe tepër malore popullsia jonë është e zënë me blegtori të imët. Vitin e kaluar në skemat e konvencionit për bujqësinë pati probleme me blegtorët që merren me bagëtinë e imët, sepse u ndoq parimi kush vjen i pari, fiton subvencionin dhe nga 200 fermerë të Bashkisë së Himarës dhe Selenicës që aplikuan, pati shumë pak fitues. Kështu do të doja ta përsërisja se të gjithë këta blegtorë që janë të regjistruar paguajnë taksat, kanë matrikullimin e bagëtive, kështu që prapë unë ngul këmbë të them se vlera e skemës për bujqësinë...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, zoti Vullnet, bëni propozimin!

Vullnet Sinaj- Sa u përket emergjencave civile dhe dëmeve që janë shkaktuar nga tërmetet në buxhetin e këtij viti, nëpërmjet një akti normativ iu dhamë mundësinë të ndihmonim të dëmtuarit nga tërmeti në Durrës, dhe në Tiranë, por ama nuk duhet të harrojmë edhe tërmetet e tjera që kanë ndodhur vitin e mëparshëm. Nuk mund t'i lëmë ata banorë pa i ndihmuar. Sot në mëngjes kam pasur takim me Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe ju garantoj se për zonën e Smokthinës dhe Himarës dokumentacioni do të jetë i plotë këtë vit, kështu që kërkoj nga Ministria e Financave të parashikohen, sepse vlera që ju keni parashikuar është e vogël krahasuar me ato që kërkon Drejtoria e Emergjencave Civile, krahasuar edhe me ato që kanë nevojë qytetarët shqiptarë. 1 miliard është vlera normale për këtë vit dhe vitin tjetër të mbylleshin këto probleme.

Arben Ahmetaj – Pra, propozoni 1 miliard.

Po, Xhavit keni fjalën.

Xhaviti Bushaj – Faleminderit!

Unë e vlerësoj maksimalisht pjesën e shpenzimeve të këtij projektbuxheti, sepse tregon sasinë e parave që ne vëmë në dispozicion të qytetarëve tanë në mbështetje të atyre reformave që ka ndërmarrë qeveria jonë.

Unë kam disa pyetje dhe do të doja të përqendrohesha te bujqësia. Duke ardhur nga ajo zonë, që unë përfaqësoj, pikërisht qytetarët e Fierit, të cilët japin kontribute të konsiderueshme në këtë buxhet si në pjesën e të ardhurave, ashtu edhe të shpenzimeve, do të ndalesha pak te prioritetet dhe rezultatet që do të arrijmë nga ky projektbuxhet sa i përket mbrojtjes së tokës nga gërryerjet në luginat e lumenjve. Gjatë këtyre viteve janë ndërmarrë një sërë investimesh që kanë dhënë rezultatet e tyre, por ende janë të pakta fondet e planifikuara për penelet mbrojtëse, në lumin e Vjosës, i cili është bërë një ndër lumenjtë më shqetësues sa i përket fenomenit të përmytjeve, por njëkohësisht edhe të gërryerjes së tokës. Janë me dhjetëra për të mos thënë me qindra hektarë tokë që gërryhen përditë nga këto lumenj. Unë nuk di se çfarë keni planifikuar për penelet mbrojtëse dhe në cilët lumenj, por aty është domosdoshmëri emergjente për tre segmente, në zonën e Cakranit, të Frakullës dhe të Levanit.

Njëkohësisht doja të flisja edhe për veprat ujitëse. Këtu dhe në objektivat që ka programi i qeverisë jepen disa shifra në lidhje me rritjen e sipërfaqes së ujitshme, por faktikisht nuk ka gjëra konkrete, se në cilat fusha dhe qarqe do të ndërhyhet. Për shembull nga investimi në infrastrukturën rrugore të autostradës Levan- Tepelenë, përveç shpronësimeve që fermerët e këtyre zonave nuk kanë marrë ende, madje do ta kisha pyetje sekondare të dija sa fonde janë planifikuar në ARRSH për përballimin e dëmshpërblimeve të fermerëve të këtyre zonave që janë që nga Shkodra deri në Fier, në Tepelenë dhe në Gjirokastër?

Në lidhje me rehabilitimin e rrjetit hekurudhor, ne edhe herë të tjera kemi aprovuar këtu marrëveshje edhe me qeverinë gjermane, edhe me Bankën Botërore fonde, por desha të di çfarë fondesh janë këto që planifikohen përsëri për hekurudhën Durrës- Tiranë dhe çfarë fondesh janë parashikuar për rrjetin tjetër hekurudhor Durrës-Lushnjë, Durrës-Pogradec, Durrës-Fier, sepse Fier-Vlorë është dhënë me koncesion dhe ka filluar të përdoret transporti i mallrave, por e kisha për transportin e udhëtarëve Fier-Durrës, Lushnjë-Durrës, Pogradec-Durrës, për të cilat nuk flitet dhe nuk flitet. Do të doja diçka në lidhje me transportin hekurudhor, pasi është me kosto të ulët.

Arben Ahmetaj – Me kosto të ulët? E dini besoj se subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Xhaviti – Po ta bëjmë ne rentabël.

Arben Ahmetaj- Po të ishte me kosto të ulët, do të ishte nën influencën e tregut.

Fjala për ministren.

Anila Denaj- Po e nis nga konteksti i shpronësimeve për punët publike infrastrukturore, të cilat janë ende detyrime të papaguara. Në analizën e bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Energjetikës fondi prej 3 miliardë lekësh është konsideruar një fond, i cili duhet adresuar shumë shpejt dhe me zgjidhje, që do të pasojnë krijimin e një agjencie, e cila do të adresojë menaxhimin e pagesës së këtyre detyrimeve edhe në kontekst pagesash me këste duke parashikuar edhe një projektligj se si do të bëhet kjo pagesë me këste e duke përfshirë edhe pagesën e normave të interesit për çdo afat pagese të vonuar. Kjo agjenci brenda muajit nëntor me vendim të Këshillit të Ministrave do të jetë në dijeninë edhe të grupeve të interesit, përfshirë këtu edhe komisionet. Projektligji që do të sjellë këto ndryshime juridike do të jetë duke u shqyrtuar në komisionet respektive. Nevoja është për të parë që disa detyrime të prapambetura, të cilat zënë një peshë më të madhe në shpronësimet të paguhen në një afat 5-10-vjeçar.

Në të ardhmen zëri i shpenzimeve të jetë një zë i cili të bëhet pjesë e analizës së fizibilitetit të të gjithë projektit për të gjykuar edhe për validitetin e pagesës së tij në kohë, qoftë me këste ose detyrime të menjëhershme, në mënyrë që të krijojnë një lloj qartësie të gjitha palët kur do ta marrin këtë detyrë dhe me çfarë norme interesi.

Sa i përket pjesës së bujqësisë, unë e thashë pak më parë që nevoja për të investuar në bujqësi, si sektor prioritar, është e pamjaftueshme në të gjitha aspektet e tij jo vetëm në kontekst subvencionesh, por edhe në kontekst infrastrukture. Në detajimin e buxhetit ne kemi disa zëra, të cilat në fondin prej 1 miliard lekësh që unë përmenda pak më parë del si pjesë e parandalimit të problemeve në rast emergjencash. Ka disa zona dhe është e drejtë se nuk është zona që ju përmendët, ajo e Vjosës. Arsyeja pse nuk është zona e Vjosës më lejoni ta konsultoj me ministrin përkatës, sepse duhet të jetë pjesë e një analize ose adresimi në një moment të caktuar dhe të gjitha rikonstruktionet e rehabilitimit të digave janë të listuara në zërin që thamë pak më lart.

Sa i takon hekurudhës, e pranoj se nuk është, megjithatë më duhet të konsultohem për arsyen pse nuk është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në gjykimin tonë joteknik të segmenteve se cila do të ishte ajo që do të krijonte nxitjen më të madhe, shikojmë se ka segmente në zonën e Fierit ku kalon ky lum. Megjithatë do të na duhet të konsultohemi me ministrin e linjës pse nuk ka marrë fiks këtë titull dhe objektivin e vendosjes së kontrollit të shtratit të lumit Vjosë për të mos krijuar përmytje. Mund të jetë në segmente të tjera të cilat, siç janë në zë për qytetin e Fierit mund të kenë detaje më shumë.

Sa i takon hekurudhës është një kontekst financimi i huaj me një investim 4 miliardë në total, në vitin që vjen rreth 1,2 miliardë lekë. Konteksti i infrastrukturës hekurudhore është kontekst diskutimi më shumë rajonal dhe jo vetëm lokal, duhet ta theksojmë se kjo nuk e bën projektin pak të kushtueshëm, por brenda integritit rajonal e bën të domosdoshëm. Kjo është arsyeja që mbështetja buxhetore me financim të huaj vjen si një mbështetje edhe me faza, edhe me hapa. Korridoret përcaktohen edhe nga kjo shtrirje rajonale nëse mund të dakordësojmë, sepse që të vendoset i gjithë rrjeti në funksionim do të duhet të shikohet përfitueshmëria e tij pasi krijon një kosto më të madhe se përfitimi.

Eljo Hyska— A ka në projektimin e buxhetit për emergjencat civile zë për fondet, të cilat alokohen për ndërtimin e kanaleve kulluese? Pra, a ka një hartë të zonave, të cilat janë më të rrezikuara? A ka një analizë të zonave, të cilat janë më të prekura dhe sjellin më shumë dëme financiare, pra ne a kemi një veprim proaktiv, të themi, në këtë buxhetim të emergjencave civile, që do të thotë në perceptimin tim se shpërndarja sa i përket ndërtimit të kanaleve kulluese bëhet sipas atyre që kanë një zë më të madh pranë Ministrisë së Bujqësisë. A mund të shtohet edhe komponenti i emergjencave civile, sepse bashki si Vora, Kamza, Kruja, Durrësi kanë disa vite rresht që përmyten. A ka një plan dhe një adresim të këtij plani sa u përket përmytjeve?

Anila Denaj – Për këtë më duhet pak më shumë kohë për të thënë se cilat janë planet për çdo ministri linje. Në listë të bashkive, që marrin vëmendje këtë vit në këtë fond prej 1 miliard, duke filluar nga Durrësi, Kruja, Roskoveci, kam edhe Kamzën me rezervuarin e Paskuqanit, pastaj vazhdojmë më tej me Bashkinë e Pukës, Divjakës, Durrësit, Rrogozhinës, Fierit, Ersekës e shumë bashki të tjera, të cilat konkludojnë në një fond prej 1 miliard lekësh në preventive të bashkive që kanë të bëjnë me rehabilitimin e digave ose të ujësjellësve. Kjo është një marrëdhënie e bashkive me ministrinë e linjës, unë vërtet do të shpresoja që kryetari i ri i bashkisë të këmbëngulë më shumë për të realizuar objektivat.

Arben Ahmetaj – Do t’ju lutesha, zonja Ministre, për pyetjet deputetëve për projektet, për pyetjet specifike duhen përgjigje “po”, “jo”, “e kemi”, “nuk e kemi

planifikuar”, “kushton kaq” që deputetët pastaj të kenë mundësi t’i reflektojnë në zonat e tyre me qytetarët e interesuar.

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli - Unë mendoj se do të ishte e udhës që edhe pyetjet, edhe përgjigjet të jenë për politikat kryesore që mbulon buxheti i vitit 2020. Kur diskutojmë në parim, flasim për politikat kryesore që ky buxhet me shpenzimet që ka do të mbulojë. Natyrisht, edhe kryetari, edhe ne kemi bërë një axhendë që do t’i marrim në shqyrtim një nga një, për shembull, nesër do të kemi koncesionet, por, sidoqoftë, secili është i lirë të bëjë këtë.

Unë nuk kisha ndër mend të bëja ndonjë pyetje, por duke marrë shkas nga ky vit ushtrimor buxhetor dhe nga ngjarjet që kanë ndodhur nga një vendim i qeverisë dhe ngritja e një grupi pune për të shqyrtuar çështjet që kanë ngritur studentët, kemi Paktin e Universitetit, kemi vendimin e qeverisë, kemi pretendimet e tyre, sipas të cilëve nuk u janë plotësuar kërkesat dhe nevojat, unë do të dëshiroja që të kishte një koment përgjigjeje nga ana juaj për angazhimin buxhetor rreth këtij pakti që edhe opinioni publik të njihet duke qenë se numri i pretendimeve të tyre që nga koha e deklaramentit për plotësimin e kërkesave të tyre ka filluar të përshkallëzohet, kështu që është mirë që ne të japim reflektimin me këtë projektbuxhet në fushën e arsimit, edukimit dhe sa u përket kërkesave të studentëve.

Faleminderit!

Anila Denaj – Në fillim të këtij viti ne alokuam nga fondi rezervë dhe nga fondet e tjera gati 1,7 miliardë, lekë të cilat janë pjesë e paketës së Paktit për Universitetin, konkretisht për bursat e studentëve. Në kontekstin e këtij fondi drejtpërdrejt te studentët patëm disa problematika, të cilat lidheshin me vendimmarrjen se cila do ta kishte aprovimin, bashkia, apo Ministria e Arsimit. Këto u zgjidhën. Pastaj ishte çështja se ku do të depozitohej fondi individual i studentëve, konstatuam në maj të këtij viti që rreth 3 mijë studentë nuk arrinin dot të merrnin këtë fond se nuk kishin llogari bankare, kemi asistuar edhe për hapjen e llogarisë bankare, kemi menduar edhe një asistim përmes zyrave të Postës Shqiptare, për të krijuar një bazë më të gjerë të shërbimit në mënyrë që të mos ishin detyruar për të hapur llogari ose për të mbajtur komisionin e bankës. Të gjitha këto kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm për të mundësuar që i gjithë fondi të kalojë te studentët. Mendoj se gjatë këtij viti, kemi shkuar edhe më tej, secila ministri ka një angazhim përtej ligjor, për të vijuar me mbështetjen në aspekt të punësimit dhe projekteve të tjera shtesë.

Ne mbledhemi çdo muaj nganjëherë edhe më shpesh, tani që ne jemi këtu universiteti po mbledhet nën drejtimin e Kryeministrit, sepse janë takime çdo dy javë. Për ministri të

caktuara angazhimet janë konkrete. Unë flas për ministrinë time që i ka shifrat shumë të qarta. Në raport me punësimin për studentët e ekselencës ka qenë një akses i menjëhershëm në administratën publike me një ndryshim ligjor që iu bë ligjit të nëpunësit civil, pikërisht për të pasur një mundësi frymëmarrjeje ose me kontekstin e investimeve në infrastrukturë, të tjera që janë duke u përgatitur për të përmirësuar infrastrukturën brendshme ose konvikte në 5 qytete. Kur fola për aktin normativ unë e përmenda që i janë kaluar 380 milionë lekë Fondit Shqiptar të Zhvillimit që të mundësojë një alokim të shpejtë të këtyre fondeve drejt produktit final që janë 5 konvikte në 5 qytete. Sigurisht këto janë procese që nuk do të reshtur së angazhuari si ministri deh qeveri pasi edhe vitin që vjen angazhimi total për rritje fondesh është 3, 3 miliardë lekë ku pjesën më të madhe e zë Pakti i Universitetit me 2, 4 miliardë lekë.

Arben Ahmetaj– Unë do ta bëj diskutimin tim edhe si pyetje edhe si koment në mënyrë që edhe kohën ta përmbledhim, por edhe të orientohemi te fenomenet dhe parimet e shpenzimeve buxhetore.

Po shikoj një tabelë të ministrisë suaj, ku i referoheni buxhetit fillestar të shpenzimeve totale, aktit normativ dhe të pritshmit.

Buxheti fillestar për shpenzimet totale është 519 miliardë e 577 milionë lekë. E njëjta shifër, ekzaktësisht, është edhe tek akti normativ.

Besoj se po me ndiqni, apo jo? Jemi te fiskalja nominative.

Të vazhdojmë? Dakord.

Ndërkohë, i pritshmi, nga 590 miliardë e 577 milionë lekë, më ka ardhur 506 miliardë e 290 milionë lekë, që do të thotë 13,2 miliardë lekë më pak shpenzime, gati 130 milionë dollarë më pak.

Pyetja ime është: në qoftë se ju parashikoni 13,2 miliardë lekë më pak, cila është arsyeja që ju nuk i rialokoni në pastrim llogarish për detyrimet e prapambetura? Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë është e njëjtë me atë së cilës iu referua edhe zoti Angjeli, por unë do të shkoj pak më tej: nga 1,7-miliardëshi, sa janë harxhuar sot, në 10-mujor, dhe sa studentë kanë përfituar?

Kam edhe një pyetje brenda pyetjes: sa studentë, që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike, kanë përfituar nga mbështetja buxhetore për Paktin e Universitetit?

Pyetja tjetër është sërish e lidhur me një pyetje të bërë më parë, por para se ta bëj, zonja Ministre, dua të lexoj diçka për t'u sqaruar edhe vetë.

Dua të bëj një pyetje, që ka lidhje me një paragraf që keni shkruar në relacion, në mos gaboj, te faqja 3 (besoj e keni relacionin), ku thuhet: “Në vijim të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, vend të rëndësishëm zë vazhdimi dhe konsolidimi i reformës së financimit të arsimit parashkollor. Edhe për 2020-n, fondet për pagat e edukatoreve do të rriten 10% në krahasim me 2018-n”.

Pra, a ka rritje pagash për edukatorët apo është një lapsus?

Fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 10% në vitin 2020, në krahasim me vitin 2018, jo numri? Fondet për pagat. Ju lutem, thjesht ta shënojmë!

Pyetjes “a ka politikë të re pagash” besoj se do t’i përgjigjeni edhe një herë, se u bë pak kakofoni në kohën kur pyeti deputetja, në mënyrë që ta dimë nëse ka dhe se në çfarë kategorish ka.

Pjesa tjetër është për shpenzimet për buxhetin vendor. Transferta nga buxheti i shtetit në fillestar është 25,075 miliardë lekë. Tek akti normativ është sërish 25,07. Pra, nga fillestari, totalin për shpenzimet për buxhetin vendor, për shkak të rritjes së të ardhurave të veta, e keni çuar 55, 286 miliardë lekë, ndërkohë që të pritshmin e keni gati 1,7 miliardë lekë më pak, që reflektohet drejtpërdrejt tek transferata nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor dhe transferata e pakushtëzuar e përgjithshme, me një ulje me 600 milionë. Pra, te njëra kemi një ulje 700 milionë dhe tek tjetra kemi një ulje gati 600 milionë.

Në qoftë se ne kemi detyrime të prapambetura nga pushteti vendor, cila është arsyeja që ne e ulim buxhetin e pushtetit vendor? Ne mund të vazhdojmë t’ia japim. Pse duhet t’u ulim transferatën, ndërkohë që ata nuk kanë mundësi të shlyejnë detyrimet e prapambetura, ndërkohë që u kemi lënë taksat e tyre dhe u marrim transferatën? Nuk e kuptoj. Kështu që, do të doja një sqarim.

Këtë e kam për veten time dhe ka të bëjë me rritjen e fondit të pagave. Kur të mundni, ma sqaroni se përse nuk rritet fondi i sigurimeve shoqërore, pra shpenzimet, me të njëjtin ritëm në... Pra, nëse ne rrisim fondin e pagave, automatikisht duhet ta ndjekë... Këtë ma sqaroni numerikisht, vetëm për të qenë i qartë.

Kam një pyetje tjetër, të cilën e bëra një herë, por do ta edhe bëj tani, se e kam shumë merak. Vitin tjetër keni llogaritur për interesat 40,950 miliardë lekë, pra gati 41 miliardë lekë pa 50 milionë lekë, ndërkohë që në aspektin procedural dhe teknik të daljes së eurobondit, i cili do të kombinohet dhe me *buyback*...

Normalisht. Patjetër, se po na vjen i vjetri, përfundimisht. Po, po. Po të shkosh 7 vjet ose 10 vjet, do të bësh *buyback*. Të paktën në logjikën time, je i detyruar.

Edhe sikur të mos bësh *buyback*, dalja në treg a do t'i ngacmojë interesat? Ky është merakui im. Pra, në qoftë se ne kemi llogaritur vetëm 950 milionë lekë, merakui im është se mund të ngacmohen interesat. Kështu që, do t'ju lutesha t'i referoheni...!

Në aspektin e shpenzimeve të tjera, pagesa e papunësisë është praktikisht e palëvizur, por po kaloj tek investimet publike.

Investimet publike në buxhetin fillestar të vitit 2019 janë 90,6 miliardë lekë.

Zonja Ministre, besoj se po më ndiqni me shifrat, apo jo?

Në aktin normativ keni zbritur fiks 3,1 miliardë lekë, të cilat janë reflektuar kryesisht në financimin e brendshëm, me burime të brendshme, si dhe në financimin me burime të huaja, fiks 1 miliard lekë. I pritshmi është 80,7 miliardë lekë. Pra, 80,7 miliardë lekë është gati 100 milionë dollarë më pak se buxheti fillestar. 100 milionë dollarë i bien 10 miliardë lekë, që nuk i hedhim në ekonomi.

Pyetja ime është kjo: sa është brenda investimeve publike (të njëjtën pyetje do ta bëja edhe për shpenzimet e tjera) buxheti bazë? Po bëj një pyetje tjetër më...: a ka angazhime që ngelen në mes, që nuk financohen ose financohen me pakicë vitin tjetër?

Përtej kësaj ka edhe një pyetje tjetër, që është bërë shqetësim në vazhdimësi për ministrinë tuaj: sa është angazhimi total i fondeve me burime të huaja dhe për sa vjet mund ta "gëlltisim", ta asimilojmë, brenda llogarisë kapital angazhimin që kemi me të gjithë donatorët, duke marrë parasysh që financimi i huaj është maksimumi 30-32 miliardë lekë? Ju e keni çuar në 29. Gjithsesi, ky është parashikimi juaj.

Ajo që më shqetëson është parashikimi i një uljeje nga buxheti fillestar i vitit 2019, gati 70 milionë dollarë minus. Pra, për vitin 2020, po ta krahasosh me buxhetin fillestar të 2019-s, është 70 milionë dollarë minus, gati 7 miliardë lekë më pak. 83 miliardë. Apo nuk është kështu? 83,7 nga 90,608. Pra, kemi një zbritje të konsiderueshme nga planet e vitit 2019.

Kemi edhe një zbritje të konsiderueshme nga akti normativ. Akti normativ është 87,5, ndërsa planifikimi për vitin tjetër është 83,7, që i bie diku te 3,8 miliardë më pak se akti normativ i parë i këtij viti.

Këtë pyetje po e bëj në një këndvështrim pak më të gjerë dhe më do të kaloj pak më specifikisht.

Ka detyrime të prapambetura në Ministrinë e Infrastrukturës, të cilat (ju mund të ma thoni shifrën), në informacionin tim janë rreth 6,2 miliardë lekë, që nuk janë akumuluar këtë vit, por janë akumuluar dy vjetët e fundit.

Thatë 6,5? Më fal! Në rregull.

Pyetja ime qëndron këtu: pse ne nuk i ezaurojmë detyrimet e prapambetura të Ministrisë së Infrastrukturës?

Vazhdojmë me një pyetje tjetër, përsëri për Ministrinë e Infrastrukturës. Në dijeninë time ka angazhime disavjeçare, të cilat gjysmëfinancohen, financohen ose nuk financohen vitin tjetër. Ndërkohë shoh, për shembull (nuk po marr Ministrinë e Bujqësisë, sepse ka një...), ambiente të reja, që janë objekte të rikonstruara për AKU-në qendrore, infrastrukturë kontrolli zyrtar për AKU-në, blerje, pajisje kompjuterike, objekte ujitjeje për vitin 2020, kanali ujitës e të tjera, mbrojtje nga përmbytjet në lumin Osum, në Starovë, në Berat e të tjerë, prej 763 milionë lekësh, ndërsa për Ministrinë e Infrastrukturës (më bën pak kundërshti) janë gati 1,26 miliardë lekë për projekte të reja. Ndërkohë, te Ministria e Infrastrukturës unë shikoj: Kardhiq-Delvinë është 1,374 miliardë lekë për vitin 2020. Po të fusim edhe lotin e 7, që është rreth 560 milionë, atëherë ne i nënfinancojmë lotet. Parashikimi Kardhiq-Delvinë nuk mbaron në vitin 2023.

Zonja Ministre, ju lutem, me përgjegjësinë që ka ministria juaj, detyrojeni ministrinë të financojnë projekte të reja, ndërkohë që bërja e rrugëve do të zgjatet me vite të tëra.

E dyta, shikoj që unaza e re e Tiranës vazhdon përtej vitit 2023. Pavarësisht se çfarë do të thotë opozita, unë, si përfaqësues i Kuvendit dhe i maxhorancës, përderisa janë rrugët dhe kërkohet të ketë menaxhim më të mirë financiar, dua që Kryeministri im të presë shirita në vitin 2021, kur ne të shkojmë në zgjedhje, sepse qytetarët meritojnë të marrin asete të përfunduara.

Zonja Ministre, përgjegjësia juaj është të mos i lejoni ministrinë të hapin projekte të reja pa mbaruar projektet e vjetra. E njëjta gjë vlen edhe për mbikalimin.

Tjetra, më shqetëson bajpasi Skrapar-Përmet, loti 1, i cili financohet në vlerën 199 milionë. Janë detyrime të prapambetura, apo janë punime të reja? Nëse janë të prapambetura, është histori tjetër dhe duhet ta zgjidhni në total si fenomen dhe jo rrugë më rrugë. Mos lejoni hapje të reja! Shumën prej 70 milionë dollarësh, që e mendoni të pritshme gjatë vitit 2019, ta çojmë për të pastruar detyrimet e prapambetura, sepse e shikoj që nuk do të arrijnë të harxhohen, sipas tabelës që më keni sjellë.

Bajpasi i Tepelenës financohet vetëm 305 milionë, ndërkohë që shuma është 2,2 miliardë dhe përfundon përtej vitit 2022.

Në kujtesën time, Kryeministri ka ngulur këmbë që akset kryesore, sidomos ato që përfaqësojnë konektivitet të dukshëm, si Delvinë-Kardhiq, bajpasi i Tepelenës, bajpasi i Fierit

dhe të gjitha veprat e artit të rrugës, deri në Tiranë, duhet të jenë prioritet, duhet të financohen. Pra, do t'ju lutesha ta rishikonit listën e projekteve në këtë këndvështrim për të detyruar ministrinë që të mbarojnë rrugët brenda vitit 2021, sepse një rrugë shkon maksimumi 2-3 vjet. Këtu do t'i referohesha uljes së fondit të investimeve me burime të brendshme të Ministrisë së Infrastrukturës. Nuk besoj se kemi arsye të cenojmë transportin rrugor apo Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë, si një nga ministrinë kryesore të vendit, për të mos thënë ministria më kryesore e linjës dhe më pas të lejojmë hapjen e projekteve të reja, të cilat vetëm zgjasin projektet aktuale.

Po ashtu, dua një sqarim konkret dhe numerik për financimin e segmentit Qukës-Qafë Plloçë nga Ministria e Infrastrukturës. A ka një llogari përfundimtare se sa shkon? A e kemi angazhuar financimin me fondin audit apo me fondet e tjera? Sa shkon konkretisht kjo rrugë dhe kur mbaron?

Sa është mirëmbajtja e rrugëve brenda fondit të shpenzimeve operative? Banka Botërore ka projektin e mirëmbajtjes së rrugëve. Sa është shuma që do të marrë mirëmbajtja e rrugëve për vitin tjetër, me burime të brendshme, me burime të huaja? Ka qenë 3,4 miliardë, e ndarë në 1,6 dhe 1,8 miliardë. Ku është sot? Sa do të jetë për vitin tjetër? I bie që të ndërtojmë një narrativ mirëmbajtjeje afatgjatë, përderisa jemi duke investuar te segmentet kryesore.

A ka ndonjë program specifik për 100 fshatrat, një politikë shumë interesante, që është avancuar para 2 vjetësh nga Kryeministri i Shqipërisë?

Një pyetje, për të cilën kërkoj detaje është: sa është shuma e buxhetit bazë të angazhuar dhe sa janë projektet e reja për vitin tjetër?

Janë disa pyetje, por pjesa tjetër është në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto.

Sa shkojnë investimet kapitale për arsimin dhe për shëndetësinë?

Duke iu kërkuar ndjesë, do të kthehem edhe një herë tek transporti rrugor, sepse po shikoj shënimet që kam bërë.

Te infrastruktura duhet të kemi parasysh që ju nuk parashikoni asgjë vitin tjetër apo për vitin 2021 për aksin Milot-Balldren, por parashikoni vetëm 212 milionë për vitin 2022. Ju e dini po kaq mirë sa unë që kjo e riskon pjesën e investimeve publike *perse* dhe mbulimin e koncesioneve, sepse janë të pafurnizuar.

Në këndvështrimin tim, ka një projekt shumë dinjitoz, një koncept me partneritet publik privat, më korrigjoni nëse nuk është kështu, që ka të bëjë me ndërtimin e Kampusit të Universitetit dhe nuk e shikoj të jetë i parashikuar. Nëse do të parashikoheshin edhe ajo

shumë, nëse do të parashikohej edhe Orikumi, në vazhdimësi i bie që kombinimi i investime publike në ndërtim me investimin e rrugës dhe në buxhetin e kontratave koncesionare të mos përputhej me tavanet. Mospërputhja me tavanet do të na sillte në ...

Ndërkohë, këtu kemi natyrshëm riskun e rritjes ekonomike, të të ardhurave, politika përjashtuese që mund të bëjë qeveria nesër. Thënë kjo, duhet një alert serioz, mbi të gjitha, nga Ministria e Financave. Po nga Ministria e Infrastrukturës? Ministria e Infrastrukturës, mbi të gjitha, është njësi shpenzuese më e madhe.

Ju lutem, zonja Ministre, rishikonjei edhe një herë fondin e investimeve kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës, sepse më rezulton se rrugët, që mund të mbaronin në vitin 2021, mund të shtyhen më shumë.

Cilat janë politikat e reja që financohen?

E fundit, në një moment të caktuar, unë do të flas me ju dhe me Kryeministrin, pasi të keni bërë llogarinë se sa shpenzohet për rikonstrukcione dhe për pajisje zyra, në mënyrë që të merrni një vendim nëse parashikimet kanë të bëjnë me zhvillimin e institucioneve, janë të domosdoshme dhe pa kthim, apo kanë mundësi të rialokohen në shpenzime kapitale me produktivitet për ekonominë? Kur të kemi mundësi do ta bisedojmë. Mund të bisedojmë edhe këtu me njëri-tjetrin nëse do të ketë një vendimmarrje të re.

Nuk do të heq dorë asnjë sekondë pa më nxjerrë Moza buxhetin, angazhimet, angazhimet që janë, që po ecin dhe që ju nuk i financoni plotësisht, si dhe arsyet pse nuk i financoni. Më pas do t'i lidhim me projekte të reja.

Anila Denaj – Do të adresoj dy çështjet e ngritura në fillim, në raport me Paktin e Universitetit dhe me impaktin që kanë deri më sot në raport me numrin e studentëve të adresuar. Konkretisht, nga fondi i 1,7 miliardë lekëve janë adresuar 110 mijë studentë nga konteksti i Paktit të Universitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ministria ka të drejtë t'i përgjigjet cilës pyetje të dojë në fillim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ministria ka të drejtë që pyetjes së fundit t'i japë përgjigje në fillim apo e kundërta. Nuk kemi merak për rreshtin e pyetjeve.

Vazhdoni, zonja Ministre!

Anila Denaj – Pyetja e parë kishte të bënte me fondin për pagat e edukatorëve. Kërkoj ndjesë, por më lejoni të përfundoj pjesën e studentëve.

Janë 110 mijë studentë që kanë përfutur marrëveshje me Paktin e Universitetit.

Për sa i takon fondit të pagave, edhe në relacion, por edhe në kontekst të informacionit të përgjithshëm, unë e kam shpjeguar se ka një ndryshim metodologjie në raport me numrin e fëmijëve që ndjekin parashkollorin, i cili ndryshon nga 26 deri në 18 fëmijë për edukatorë. Kjo do të bënte që numri i fëmijëve për edukatorë...

Arben Ahmetaj – Sa ndryshon, ju lutem?

Anila Denaj – Nga 26 deri në 18 fëmijë për edukatorë.

Kjo do të bënte që numri ...

Arben Ahmetaj – Nga 26 mijë, thatë?

Anila Denaj – Nga 26 fëmijë në 18 fëmijë.

Arben Ahmetaj – Dakord. Më falni!

Anila Denaj – Kjo do të bënte që numri i edukatorëve në nivelin e pushtetit vendor të rritej me 440 edukatorë. Ky numër çon në rritjen e fondit, por jo në vlerë mesatare.

Arben Ahmetaj – Pra, në vitin 2020 do të kemi 440 edukatorë të rinj?

Anila Denaj – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Duam ta kuptojmë, sepse do të na vijë pushteti vendor dhe duhet të jemi shumë të qartë se çfarë po ndodh.

Pra, ju po thoni që do të ketë edukatorë të rinj?

Anila Denaj – E thashë edhe në përfundim të fjalës hyrëse që do të jenë 440 edukatorë të rinj, kjo si rezultat i metodologjisë që çon në rritjen e cilësisë.

Arben Ahmetaj – Pra, do të jenë 440 edukatorë të rinj. Kur të mundesh, Fran, na sillni një informacion si i ndani në bashki në mënyrë që deputetët të informojnë zonat e tyre elektorale.

Anila Denaj – Gjithashtu, do të shtohen edhe 32 punonjës shtesë, përveç 440 edukatorëve, për arsimin parashkollor. Kjo bëhet për të rritur cilësinë e arsimit parashkollor, e cila sigurisht ka nevojë edhe për më shumë sesa kaq, por të paktën është një hap i parë i mirë.

Dua të ndalem pak më gjatë te pjesa e detyrimeve të prapambetura, përpara se dy kolegët e mi, zonja Dhëmbi dhe zoti Fran, të shpjegojnë më në detaje elementet e buxhetuar në projekte të reja, por jo vetëm.

Për detyrimet e prapambetura i referohem stokut të fundit të shtatorit. Konteksti i stokut të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka dy komponentë. Kjo është edhe në zërat e ministrive të tjera, por këtu është një shumë edhe më e lartë.

Në total stoku në fund të shtatorit ka qenë 5 miliardë lekë, nga të cilat 3,4 miliardë janë të lidhura me pjesën e detyrimeve të prapambetura për kontrata, të cilat nuk janë paguar ende, qoftë për punët publike, qoftë për mirëmbajtjen, kurse 1,6 miliardë lekë janë për vendime gjyqësore. Të dyja këto përbëjnë një stok prej 5 miliardë lekësh.

Më lejoni të theksoj se në qasjen, që e kemi të përbashkët, në raport me çeljen e fondeve në fillim të këtij viti, unë e thashë edhe një ditë më parë, është bërë çelja e fondeve buxhetore për vleftën në fillim të vitit, në 3-mujorin e parë, për 2,5 miliardë lekë për ARRSH-në, në mënyrë që të paguhen detyrimet e prapambetura këtë vit dhe të kemi mundësi që vitin që vjen të paguajmë detyrimet e prapambetura për mirëmbajtjen, sepse edhe fondi prej 2,5 miliardësh nuk e plotësonte totalisht fondin e mirëmbajtjes që ishte shtesë shumës 2,5 miliardë.

Konstatojmë që kjo nuk është shlyer në të njëjtin ritëm me parashikimin për arsye të një procesi auditimi që ka nisur për të gjitha projektet dhe faturat, të cilat janë në disponibilitetin e tyre për të bërë pagesën. Parashikimi në fund të vitit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura do të jetë më pak nga sa e prisnim si ministri. Ndryshe parashikohej situata me detyrimet e prapambetura në një institucion tjetër.

Ju përmendët pak më parë, zoti kryetar, kur po flisnim për shëndetësinë dhe listën e barnave, fondin e detyrimit të prapambetur të shëndetësisë, sikurse edhe unë iu përgjigja çështjes së adresimit të listës së barnave në kontekstin e zërave që janë brenda. Këto i takojnë listës së barnave, por ne flasim për kontekstin e vleftës totale që kemi në përdorim. Këtë vit është arritur të kursehet nëpërmjet negocimeve dhe të ulet në mënyrë të ndjeshme fondi i detyrimeve të prapambetura, sidomos i prodhuar në 2 vitet e fundit. Parashikohet shlyerja e të gjitha detyrimeve në fund të këtij viti. Të paktën ky raportim vjen nga Ministria e Shëndetësisë.

Arben Ahmetaj - ... prapambetura në fund të këtij viti. Zero.

Anila Denaj – Nga FSDKSH-ja. Nga shëndetësia.

Ndërsa në raport me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si rezultat i këtij procesi auditimi që u përmend pak më sipër, thamë që nuk parashikojmë një ulje të konsiderueshme këtë vit.

Stok tjetër të detyrimet e prapambetura janë edhe detyrimet e pushtetit vendor, që shkojnë afërsisht në shifrën 7 miliardë lekë. Besoj që zoti Fran do të na japë pak më shumë shpjegime se si është menduar pagesa e tyre në çeljen e buxheteve duke filluar nga viti i ardhshëm dhe në vitet në vijim, në mënyrë që adresimi i stokut të ulet më tej. Vlen të

theksojmë se nga 11,6 miliardë lekë stok detyrimesh në fillim të reformës në vitin 2016, sot kemi 6,7 miliardë lekë. Kjo duhet të parashikohet në një projeksion 3 - 4 vjeçar në mënyrë që të kemi mundësi të parashikojmë projeksione të reja shtesë.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, ju lutem, pa jua ndërprerë mendimin, dua t'i bëj një pyetje zotit Fran.

Zoti Fran, pse ia ulni gati 1,5 miliardë pushtetit vendor nga transferta e pakushtëzuar dhe nga transferta e? Që nga akti normativ, që u bë para një muaj e gjysmë, dhe deri tani. Në tabelën që më ka sjellë ministria ju thoni që transferta nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor në buxhetin fillestar ishte 25 075.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse nuk duron?

Me aktin normativ është e njëjta, thashë, kurse me të pritshmin është 24 395.

E dyta, shpenzimet për buxhetin vendor, transfertën e pakushtëzuar sektoriale, që është granti specifik, e keni të plotë, kurse transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme e keni me – 600 milionë të pritshmin. 17 miliardë e 52. Ajo që ribëni përsëri, Fran, është që erdhët me akt normativ, në të drejtën tuaj, i rritët shpenzimet për pushtetin vendor për shkak të të ardhurave të veta nga 51,286 miliardë në 55 286 miliardë, kurse të pritshmin e keni gati 1,7 miliardë më pak.

Fran, nuk prodhon vetëm ti tabela në Ministrinë e Financave, prodhon edhe Moza. Unë e kam shqetësim. Përderisa pushteti vendor ka detyrime të prapambetura, t'i lihen ato para.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mendimin tim, të mos them 13 miliardë, sepse varet edhe nga realizimi i të ardhurave, por të paktën 7 miliardë që ngelen nga akti normativ, që ishte para 1 muaji e gjysmë, me të pritshmit e 31 dhjetorit. Janë 70 milionë dollarë. Të kemi mundësi të pastrojmë detyrimet e prapambetura dhe mos të ulim investimet, sepse i parashikoni 80. Nuk ka arsye. Pra, nga 90 shkuan në 83 dhe të pritshmin e keni 80. Investimet duhet të hidhen në ekonomi dhe të përdoren për pastrimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura. Nëse doni të pastroni ndonjë gjë që keni tepër, jepeni bonus për pensionistët. T'u japim 50 – 60 mijë lekë pensionistëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, është puna juaj, por të ruajë nivelin e viteve dhe premtimin që ka bërë Kryeministri i Shqipërisë në programin e qeverisë.

Fran, pse 1,7-i ikën dhe nuk i jepet pushtetit vendor? Ose do të bësh premtim këtu që nuk do ta cenosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Moza, mbulon Franin? Dakord, jepe përgjigjen Moza

Mimoza Dhëmbi – Do të doja ta jepja në përgjithësi.

Arben Ahmetaj – Jo, e dua në veçanti.

Mimoza Dhëmbi – Ai është vlerësim sa mund të shkojnë shpenzimet lokale deri në fund të vitit. Pra, aty nuk ka shkurtime. Është vlerësim. Vlerësimi bëhet me qëllim që ne të sigurohemi që në fund do të ruajmë nivelin e deficitit, balancën primare, borxhin ...

Arben Ahmetaj – Jo, jo, nuk mund t'ia thuash këtij komisioni këtë. Nëse ti ke detyrime ...

Mimoza Dhëmbi – E fillova nga buxheti lokal për të thënë të gjithë kolonën e të pritshmit, sepse ju thoni mos shkurtoni shpenzimet kapitale. Ne nuk po i shkurtojmë. Ideja është që shpenzimet kapitale me rrjedhje të lirë, po t'i lejosh, shkojnë aty. Nisur nga niveli i realizimit sot, që është ...

Arben Ahmetaj – 61%, që është pak më pak se 50 miliardë ...

Mimoza Dhëmbi – Dhe 44% financim i huaj.

Arben Ahmetaj – Do të thotë që për dhjetë muaj janë harxhuar 5 miliardë çdo muaj. Pra, për një muaj duhen 300 milionë dollarë, 30 miliardë lekë. Do të thotë 15 miliardë lekë në muaj, që ju e dini po kaq mirë sa unë që është e pamundur. Ato para duhet të hidhen në projektet që kanë detyrime të prapambetura. Të pastrohen llogaritë. Këtë diskutim kemi.

Mimoza Dhëmbi - Pse nuk hidhen në projektet që kanë detyrime? Ne do t'i hedhim dhe jemi duke bërë disa rialokime, në fakt, por do të shikojmë edhe balancën e të ardhurave. Cili është parashikimi i të ardhurave.

Arben Ahmetaj – Cili është parashikimi i të ardhurave?

Mimoza Dhëmbi – Ka një minus në të ardhura, i cili balancohet ...

Arben Ahmetaj – Sa është minusi?

Mimoza Dhëmbi – Aq sa është diferenca nga akti normativ tek i pritshmi ynë. Ne supozojmë një të pritshëm dhe nga ana tjetër shikojmë çfarë të barturash kemi në krahun e shpenzimeve.

Arben Ahmetaj – Sa? Të bëjmë llogaritë.

Mimoza Dhëmbi – E gjithë diferenca. 13. Ato që cituat ju.

Arben Ahmetaj – Sa?

Mimoza Dhëmbi - 13.

Arben Ahmetaj – 13 miliardë.

Mimoza Dhëmbi – Po.

Arben Ahmetaj – 13 miliardë nga akti normativ apo nga fillestari?

Mimoza Dhëmbi - Me sa di unë nga fillestari është 11 miliardë. Më duhet ta verifikoj këtë.

Arben Ahmetaj – Ku ta verifikosh? Nëse nuk i ke tabelat i kam unë.

Mimoza Dhëmbi – Akti normativ, se kam të pritshmin.

Arben Ahmetaj – E kam unë aktin normativ.

Mimoza Dhëmbi - Ideja është që çfarë minusi ka nga të ardhurat balancohet me të gjitha kursimet nga shpenzimet. Çdo gjë që tepron, rialokohet.

Arben Ahmetaj -Ju po i thoni ish - ministrit të Financave teorinë e vjetër sa bota që po qe se ... Unë po të pyes specifikisht sa është? Sa e planifikoni? Ti që vë gërshërën poshtë, e di se sa të shkurtohet ose të zgjatet metri sipër?

Mimoza Dhëmbi – 11 miliardë. Nëse ju e llogaritët 13 miliardë, unë po e pranoj për momentin, sepse nuk e kam treguesin.

Arben Ahmetaj – 13 miliardë nga fillestari apo nga akti normativ?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, zoti Roshi, sepse po pyes punonjësit e ministrisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të lodhem, sepse këtë punë kam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam shqetësimet e mia, nuk e pyes kot. Unë e pyes për të parë shpenzimet.

Moza, të lutem, ma thuaj?

Mimoza Dhëmbi – Meqenëse nuk e kam për momentin ,...

Arben Ahmetaj – Meqenëse nuk e ke për momentin, nesër në orën 07:45 të mëngjesit na e sill personalisht.

Mimoza Dhëmbi – Mund ta gjej edhe tani tabelën. Logjika ...

Arben Ahmetaj – Dakord. Mos na e thuaj shifrën.

Mimoza Dhëmbi – Logjika është që deficitin ngelet i njëjtë në të gjitha raportet. Pra, edhe në fillestar, edhe në akt normativ, edhe në të pritshëm ...

Arben Ahmetaj – Moza, pse ia citon ish-ministrit të Financave ligjin. Ti po thua ligjin që deficitin është i paprekshëm. Ne e kuptojmë. Meraku im ...

Mimoza Dhëmbi – Merakut po i përgjigjem.

Arben Ahmetaj – Meraku im është te shpenzimet, te këputja e kapitaleve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, sille nesër të pritshmin në mënyrë që të ulemi me ministren përtej kamerave dhe të diskutojmë tamam sa shkon, sa nuk shkon dhe çfarë të pritshmi kemi? Ku goditemi? Ku ngrihemi? Ku shtojmë? Ku pastrojmë? Ku ulemi? Kjo është e gjithë logjika.

Mos i hajde kot vërdallë shifrës, sepse e kemi në kurriz edhe ju edhe ne. Nuk e keni vetëm ju në kurriz. Ne nuk kemi përgjegjësi për ...? Patjetër që kemi. E gjithë historia është që të bëjmë një parashikim. Pse? Sepse dëgjova që do të bëni akt normativ. Apo nuk është kështu? Po përgatisni akt normativ?

Mimoza Dhëmbi – Nuk kemi filluar, por kemi një ide.

Arben Ahmetaj – Meqë thoni që nuk keni filluar, bonusin nga e nxirrni?

Mimoza Dhëmbi – Bonusin e nxjerrim përtej kësaj, përtej rialokimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nga e nxirrni bonusin?

Mimoza Dhëmbi – Nga kursimet mbi këto shifra, sepse këto shifrat e pritshme garantojnë deficitin.

Arben Ahmetaj – Cilat kursime? Ku i ke kursimet?

Mimoza Dhëmbi – Ne mendojmë që brenda skemës së sigurimeve shoqërore ka ende kursime, jo të mjaftueshme për të dhënë bonusin, por ne do të gjejmë dhe të tjera.

Arben Ahmetaj – Atëherë do të prekim shpenzimet për vitin tjetër, apo jo? Pra do të prekim planifikimin e shpenzimeve, se i bie që paskemi planifikuar më shumë.

Faleminderit!

Do ta shohim më pas nen për nen te shpenzimet. Pra, deri në fund të vitit... Atëherë, ma planifiko bonusin që sivjet për vitin tjetër.

Mimoza Dhëmbi – Ajo skemë është 130-miliardëshe. Dhe në 130 miliardë për të gjetur 1 miliard apo 800 milionë nuk është ndonjë zor i madh, pra është një përqindje...

Arben Ahmetaj – Nuk është zor i madh? Po pse keni zor të madh për t'i gjetur Ministrisë së Infrastrukturës 2 miliardë, kur vjen në fund të vitit dhe thua se nuk është zor i madh për t'i gjetur? Gjeji sot 2 miliardë Ministrisë së Infrastrukturës, që t'u përgjigjet angazhimeve. Pse nuk ia gjen, meqë nuk qenka zor i madh për 2 miliardë?!

Mimoza Dhëmbi – Ne...

Arben Ahmetaj – Dakord, e kuptova. Të lutem! Siç e shikon, komisioni është njësh me ju, madje edhe opozita kur bën pyetje është dashamirëse, sepse e kupton edhe se si lëviz buxheti, por t'i themi gjërat specifikisht me shifra, se të vish e të thuash që nuk preket deficit, tani.. Që nga '92-shi e dimë që nuk preket. Në rregull.

Kishit ndonjë gjë tjetër?

Mimoza Dhëmbi –Për shembull, një nga pyetjet tuaja, që e kam shënuar, ishte për politikën e reja dhe *baseline budget*.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Ne nxorëm një listë me të gjitha investimet e reja. Në fakt, po ta vini re, duket politika jonë e kujdesshme, kur kemi investuar te projektet ekzistuese. Projekte të reja janë vetëm 6 miliardë e 280 milionë lekë. Listën ia kemi dërguar sekretarisë. Pra, po të filtrosh listën e investimeve të plota që ju kemi sjellë, ka një kolonë të re në vazhdim. Kemi nxjerrë vetëm të rejat dhe del 6,2 miliardë në 80 miliardë.

Arben Ahmetaj – Më falni, këto 6,2 miliardë, do t'ju lutesha...

Mimoza Dhëmbi – Kemi një listë.

Arben Ahmetaj – ...t'i filtron, të na i jepni një për një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, pashë aty rikonstruksione e të tjera. Është ajo që folëm me ministren, që duhet ta konsultojë një herë vetë ministrja me Kryeministrin se si do ta përfaqësojë këtë historinë e rikonstruksioneve (aty ku janë të domosdoshme, janë, aty ku nuk janë...), pajisjet e zyrave e të tjera dhe t'i referohemi... Mbase nuk kemi arsye të hapim të reja. T'i japim Ministrisë së Infrastrukturës para për të shlyer detyrimet, se pa dashje pastaj krijojmë detyrime mbi detyrime. Kjo është historia. Dakord. Gjithsesi, ne...

Anila Denaj – Mundem?

Arben Ahmetaj – Po, patjetër.

Anila Denaj – Nuk dua të ndërhyj tashmë në diskutimin dhe debatin e shifrës së të ardhurave të parashikuara, sepse ne i shkuam dje në detaje kësaj shifre dhe të gjitha arsyeve pse ajo është në minus. Besoj se në një buxhet, përgjegjësi e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe të gjitha institucioneve, ulja e të ardhurave do të reflektohet edhe në ulje të shpenzimeve. Kjo është një politikë e logjikshme.

Sigurisht, kur vendos të bësh një akt normativ me pritshmërinë që kemi akoma disa muaj (i referohem aktit normativ të ndodhur para një muaji), me pritshmërinë që projeksionet e fund vitit të jenë më optimiste se ato që parashikohen, në gjykimin tonë, për të shkuar tek të ardhurat me një minus prej 13 miliardë lekësh dhe për të qenë brenda, na u desh të ngrinim edhe projekte, të cilat sot i kemi të efektuara. Ministria që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ngrirja e këtyre projekteve është Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, me gati 3 miliardë lekë të ngrira si investime. Kjo është një politikë prudente. Sigurisht, ne nuk do të na interesonte të ngrinim asnjë projekt. Do të donim vërtet që, si angazhimi i qeverisë, si angazhimi i Kryeministrit, si angazhimi i vetë ministrisë për të përfunduar rrugët, të ishte brenda vitit apo për të shlyer detyrime të prapambetura, të cilat, siç jua thashë edhe në fillim, vijnë si një qasje edhe prudente drejt një procesi auditimi.

Megjithatë, ngrirja e projekteve deri në fund të vitit, për të ruajtur këta parametra në shifrën e 3 miliardë lekëve, ku një pjesë është nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, gati 1 miliard, nëse nuk gabo, një pjesë tjetër e konsiderueshme, 1,5 miliardë te Ministria e Infrastrukturës, pjesa tjetër është te projektet që nuk kanë avancime shumë të mira në projektet e tyre, është një politikë që sot e kemi të efektuar. Në momentin më të parë kur do të fillojmë diskutimin, nëse do të ketë një akt tjetër normativ, do të shikojmë nëse kjo do të shkojë, së pari, në shkrirje, sepse ngrirja sot është formale dhe është bërë pikërisht me këtë objektiv në mendje, nëse e mendojmë, minusin e 13 miliardë lekëve tek total i të ardhurave.

Nëse ne do të arrinim me të pritshmin e vitit 2019 me projeksione më optimiste se minus 13-miliardëshi, ku synojmë minus 11-miliardëshin, atëherë të kishim mundësi që nga ngrirja e projekteve, që është kryer, i pari menjëherë do të ndodhte që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës të bënte pagesat për projektet që ka.

Në gjykimin e përbashkët, që detyrimet e prapambetura janë të parat që paguhen, ne besoj se nuk devijojmë në këtë qasje. Megjithatë, besoj se është një obligim i vetë ministrive, kur vendosin të bëjnë pagesa kundrejt një analize të kujdesshme nëse këto fatura duhet të auditohen pak më parë.

Për të thënë në fund një detaj, ne nuk e kemi parashikuar në fillim të vitit fondin për pensionistët. 2-3 herë, kur jam pyetur edhe nga gazetarët, kam thënë se ky është një ushtrim, ku fundi i vitit merr alokimet, por kjo është një qasje që qeveria duhet ta adresojë në vendimin me aktin normativ, kur kjo të shtrohet për diskutim në muajin dhjetor.

Dy elemente shtesë në raport me përqindjen që kanë ndaj produktit të brendshëm bruto arsimit dhe shëndetësisë: shëndetësia është në 3%, ndërsa arsimi në 3,4%. Sigurisht, nëse

diskutojmë raportin se pse infrastruktura, si të thuash, merr goditjen më të parë nga ngrirja e këtyre projekteve, besoj se e shpjegova edhe kur iu përgjigja pyetjeve që më bëtë. Kjo nuk do të thotë që ne kemi si objektiv të reduktojmë ritmin në punët publike të infrastrukturës rrugore, por kjo është një ecuri pak më e ngadaltë, qoftë e investimeve me financim të brendshëm, qoftë e financimeve të jashtme të punimeve në këta sektorë.

Sigurisht, ka edhe elemente të tjera shtesë...

Arben Ahmetaj –Ministre, meqë nuk ka medie dhe, gjithsesi, opozita “na jep dru” çdo ditë, problemi i infrastrukturës është se nuk ka para, se kompanitë kanë ecur. Pra, të mos e bëjmë debat me njëri-tjetrin, sepse edhe ju e dini, edhe ne e dimë, që, për shembull, janë 3-4 projekte që sot kanë ecur me të paktën 1,7 deri në 2 miliardë në total. Pra, po të kishte para Ministria e Infrastrukturë do t’i kishte paguar dhe do të kalonte në fazën tjetër.

Bëra një pyetje dhe e dua përgjigjen.

Mos u habit, Moza. Ti do të mbash përgjegjësi për 3 nga këto, që i kam kapur unë, që i ke shkurtuar ti, se nuk i ka kapur ministrja ato. Do t’i korrigjoj unë dhe Anastasi. Tani nuk kemi medie. Ti ke prerë projekte në mes. Ti mban përgjegjësi. Po, ti.

Tani, me lejen e ministres, unë do të merrem me ty. Meqë je punonjësja e ministres, në respekt të saj, se e kam edhe mike dhe meqë nuk kemi medie tani, nuk priten projekte që ecin. Nejse! Do ta mbyllim tani. Dua vetëm 2 shifra, Moza.

Sa është mirëmbajtja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimoza Dhëmbi –Mirëmbajtja e rrugëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Hape nesër diskutimin direkt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Moza, më thuaj shifrën e mirëmbajtjes dhe Banka Botërore dhe...

Mimoza Dhëmbi -Mirëmbajtja nga buxheti i shtetit, 1,6 miliardë. Mirëmbajtja nga Banka Botërore, 1,8 miliardë në 2020-n, 1,8 miliardë në 2021-shin dhe 1,9 në 2022-shin.

Arben Ahmetaj – Një sekondë!

Fondet e brendshme janë 1,6.

Mimoza Dhëmbi - I jashtmi 1,8 në vitet ’20 e ’21 dhe 1,9 në vitin ’22.

Arben Ahmetaj – Pra, është 3,4 sërish.

Mimoza Dhëmbi - Po.

Arben Ahmetaj – Sa mbyllet mirëmbajtja këtë vit?

Mimoza Dhëmbi - Do të mbyllet patjetër 100%, se ka edhe detyrime të prapambetura.

Arben Ahmetaj – *Thank you!*

Për 100 fshatrat nuk më thatë... Mos më thoni që i keni marrë inat 100 fshatrat.

Mimoza Dhëmbi -100 fshatra këtë vit kanë mbetur me 200 milionë, sepse nuk ka ecur si projekt, pavarësisht se kishte 1 miliard. Është shkurtuar me aktin normativ. Pra, tani është 200 milionë.

Arben Ahmetaj – 200 milionë? Nga 2 milion për fshat? Mirë jeni!

Mimoza Dhëmbi - Vitin tjetër është 350.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Qartë.

Zoti Roshi, do të mbyllë...

Mimoza Dhëmbi- E do edhe Qafë-Plloçën?

Arben Ahmetaj – Qukës -Qafë-Plloçë ma jep me shkrim, se e dua me përgjegjësi.

Mimoza Dhëmbi - Kërkesa shtesë, 80 milionë.

Arben Ahmetaj – Qukës-Qafë-Plloçë ma sill me shkrim nesër, se e dua me përgjegjësi, Moza, dhe të mos e firmosë ministrja, por ta firmosësh ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni kërkuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – ...sa për ta konsoliduar kërkesën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e bën dot. Kërkesë shtesë nuk ka.

Arben Ahmetaj – Ma jepni me shkrim, se dua ta fus në dosje.

Moza, e dua me shkrim dhe të firmosur nga ty, se ke qenë edhe drejtoreshë e borxhit.

Zoti Roshi, mbylle...

Artur Roshi – Te fshatra turistike, në vijimësi edhe të asaj që thotë kryetari, bëhen qendrat e fshatrave dhe nuk bëhet lidhja me rrugët, pra nuk bëhen asfaltimet e tyre. Nga 100 fshatrat, më mirë të bëjnë 10 fshatra dhe të bëhet lidhja me akset kryesore, sepse ato nuk funksionojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'kanë ku t'i gjejnë. Atë thamë ne. Le ta bëjë! Po e bëri, në rregull. Logjika është që nuk funksionon. Nëse ti e bën fshatin dhe nuk e lidh me aksin kryesor, nuk funksionon.

Arben Ahmetaj- Zoti Roshi, fokus te ministrja, bëj pyetjen ose...

Artur Roshi – Nuk kam qëllim të bëj pyetje se po flasim... Ideja është të dalim nga korniza e diskutimeve....

Kemi projektin “100 fshatrat”. Me si di unë, si inxhinier, shumë nga këto fshatra nuk lidhen me akset kryesore, që do të thotë se ju rregulloni fshatin në qendër, por turizmi nuk funksionon pa infrastrukturë rrugore. Rrugët janë të paasfaltuara. Po marrim shembullin e arkeologut nga Tepelena, që bëri fshatin e vet.

Si e ka emrin ky, që ka qenë drejtor i turizmit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Nivica.

Nivica rrugën e ka copë-copë. A mund të bëhet turizëm aty? Kjo është qesharake.

Pra, nga 100 fshatra më mirë bëni 10 fshatra, që të dimë se ato funksionojnë, sepse ne kapitalizëm, Ministre...

Arben Ahmetaj – Ajo është edhe logjika e qeverisë, që fokusohet te një grup fshatrash, te 5 fshatra, 10 fshatra e me radhë vit pas viti.

Artur Roshi – Me gjithë rrugët, jo të bësh vetëm qendrat dhe nuk bën rrugë. Nuk funksionon...

Arben Ahmetaj – Është qasje e integruar e qeverisë. Pra, merr qendrat e fshatrave, rrugët e aksesit...

Artur Roshi – Dakord, por të fillojë të prodhojë para dhe me paratë që fiton nga turizmi i 5 fshatrave të bësh të 7-in vitin që vjen. Kjo është logjika.

Ministre, kam edhe një gjë tjetër për rrugët e turizmit. Ju vazhdimisht keni thënë se e kemi vëmendjen tek turizmi. Normalisht, impaktin tek turizmi e jep infrastruktura. Rruga Kardhiq –Delvinë, për mua, është një aks kryesor, pavarësisht se... Pse është aks kryesor? Sepse ke gjithë bregdetin atje, ku priten të ardhura. Nëse ti e ndalon, nga do të vijnë të ardhurat? Vitin që vjen ekonomia do të jetë në rënie, do të jemi në një situatë tjetër edhe më të rëndë, sipas meje. Në kapitalizëm të ardhurat shikohen në kohë, jo në para. E ka thënë Aristoteli...

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, do t’ju lutesha, se e mbajtëm ministren 3 orë në komision...!

Artur Roshi – Kaq. Mbarova.

Arben Ahmetaj – Për korrektesën tuaj, edhe të pozitës, ministrja iu përgjigj në detaje të gjitha pyetjeve. Nëse ka ndonjë gjë, që ju mendoni se do detajim të mëtejshëm, ia

kërkojmë ministres dhe stafi i saj, qoftë Frani, qoftë Moza, qoftë Zana, si punonjës të Ministrisë së Financave, mund të na japë detaje projekt për projekt. Pra, në qoftë se keni akoma pyetje pa u shteruar dhe doni më tepër detaje, nëpërmjet sekretarisë, ju lutem, t'i dërgohen ministrisë dhe deri nesër pasdite...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre! Faleminderit edhe stafit tuaj!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti